

FATKEQËSITË NATYRORE,  
PËSIM APO MËSIM? l.fq. 2

RINIA MES SFIDAVE  
DHE ARDHMËRISË l.fq. 41

SHKAQET QË NDIHMOJNË NË  
BRAKTISJEN E MËKATEVE l.fq. 44

# Dëlirje & Edukim

DHJETOR 2010 | DHULHIXHXHEH 1431 - MUHARREM 1432 | NR. 20 | ÇMIMI 1€

REVISTË MUJORE FETARE EDUKATIVE KULTURORE SHKENCORE

Alkooli Kamata  
Sihri Homoseksualizmi  
**MËKATET**  
**MËDDHA**  
Lënja e Namazit Vetëvrasja  
Imoraliteti Shirku  
Vjedhja Kumori

"Dhe mos ju afrohuni mëkateve të hapta apo të fshehta" El En'am 151

# Libraria Vlera

Gjilan

*Libraria Vlera, gjendet përballë Fakulltetit të  
Edukimit 60000 Gjilan*



*Në librari kemi edhe literaturë për huazim dhe lexim të tyre...*



# Kujdes

## Musliman dhe Muslimane

Transmetohet prej Ebu Hurejres se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Largohuni shtat gjërave shkatërruese.”* I thanë: *O i Dërguari i Allahut cilat janë ato?* Ai u përgjigj: *“Shirku në Allahun, Magjia-sibri, vrasja e njeriut që e ka ndaluar Allahu veçse me të drejtë, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, kthimi mbrapsht nga fushëbeteja, shpifja ndaj besimtareve të pastërta”.* Buhariu



## MOTËR DHE VËLLA I DASHUR BESIMTAR!

MOS E HUMB SHPRESËN KURRSESI NDAJ MËSHIRËS  
SË KRIJUESIT SEPSE AJO KA PËRFSHIRË ÇDO GJË.  
KTHEHU TEK AI ME PENDIM DHE ANËTARËSOHU  
SËRISH NË RADHËT E PASUESVE TË URDHRAVE TË  
TIJ, SE VETËM PALA E TIJ QË BESUAN ATË, QË PASOJ-  
NË PROFETIN E TIJ DHE FALIN NAMAZIN E JAPIN ZE-  
KATIN JANË VËRTET MIQTË DHE MBROJTËSIT E TU.  
ALLAHU I LARTËSUAR THOTË: “MIQTË DHE  
MBROJTËSIT TUAJ JANË VETËM ALLAHU, I DËRGUARI  
I TIJ DHE BESIMTARËT QË FALIN NAMAZIN DHE  
JAPIN ZEKATIN, DUKE QENË TË PËRULUR (NË ADHU-  
RIM) NDAJ ALLAHUT. E, ATA QË MARRIN PËR MIK  
DHE MBROJTËS ALLAHUN, TË DËRGUARIN E TIJ DHE  
BESIMTARËT, (TA DINË SE) PA DYSHIM PALA E ALLA-  
HUT DO TË JETË FITUESE.”  
NË FUND, E LUS ALLAHUN E LARTËSUAR ME EMRAT E  
TIJ TË MIRË DHE CILËSITË E TIJ TË LARTA QË TË NA  
BËJË FALËS TË RREGULLT TË NAMAZIT DHE T’I UD-  
HËZOJË TË GJITHË ATA QË E KANË LËNË PAS DORE  
KËTË OBLIGIM MADHËSHTOR!



## EDITORIALI

*Xheladin LEKA*

Kalo edhe një vit ..... 2

*Fehmi DALIPI*

Vlera e të qarët nga frika e Allahut ..... 4

*Mr. Selatin MEHANI*

Mos u zemëro! ..... 7

*Mr. Fidan XHELILI*

Parathënia e ibën Maxhes Libri mbi Sunnetin ..... 11

*Xhabir SHEME*

Të njohim të Dërguarin e Allahut Muhamedin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ..... 13

*Muhamed ibën Salih el Uthejmin*

A ka më të drejtë se Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ..... 18

*Dr. Muhammed ba Kerim Muhammed ba AbdAll-Ilah*

Mesatarja e Ehli Sunnetit në lavdërimin e Profetit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ..... 20

*AbdulMelik - Besfort MAXHUNI*

Fragmente nga edukata e sahabëve me Pejgamberin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem këshilla dhe mësimë edukative për ne ..... 25

*Adem AVDIU*

Përgjigje të qarta ndaj dyshimeve me të cilat argumentohet lejimi i mevludit ..... 29

*Husejn Ali SHEJH*

Obligueshmëria e të distancuarit nga të përfolurit e nderit të të tjerëve ..... 32

*Abdurrrhman bin Nasër Es-Sa'di*

Sheriati është ndërtuar mbi dy baza ..... 36

*Zejd HAZIRI*

Koment i shkurtër i muhadithit të Medinës ..... 39

*Unejs MURATI*

Si të lumturohet jeta e dy bashkëshortëve ..... 44

*Dr. Abdul Kerim bin Muhamed el-Lahim*

Trashëgimia në Islam (V) ..... 45

*Kryeredaktor:*

Unejs MURATI

*Zv. Kryeredaktor:*

Mr. Fidan XHELILI

*Anëtarët e revistës:*

Adem AVDIU

Sabahudin SELIMI

Xheladin LEKA

*Bashkëpunëtorët:*

Bali SADIKU

Fehmi DALIPI

Lirim SADIKU

Namik VEHAJI

Shuaib REXHA

*Redaktor gjuhësor:*

Arian KOÇI

*Boton:*

*Shtëpia botuese*

**Atik**

Gjilan, Republika e Kosovës

*Tirazhi: 1000*

*Adresa:*

Rr. M. Idrizi p.n 60000 Gjilan

Republika e Kosovës

Tel: 044 988 400

E-mail: delirjedheedukim@gmail.com



# KALOI EDHE NJË VIT

*O njeri i dobët, të bëj thirrje të ndalesh, të marrësh mësim, ngase koha dhe kalimi i shpejtë i saj është një mësim i madh për ty. Mendo një çast për mijëra vite që kanë kaluar para se ti të ishe në këtë botë dhe për qindra apo mijëra të tjerë që do të kalojnë, me lejen e Allahut, duke mos qenë ti prezent.*

Njëra nga mënyrat e mësimit dhe të përmirësimit është të mendosh dhe të meditosh për kalimin e vitit, për ikjen e kohës me shpejtësi marramendëse dhe gjurmët madhore që lënë kjo gjë. Por ajo që konsiderohet edhe më e çuditshme se ky është njeriu, krijesë e dobët dhe me zemër të plogësht, që gjatë gjithë vitit dëgjon thirrës për ta shpëtuar, përjeton ngjarje për të mos u harruar, sheh me dy sytë e ballit ngjarje që kurrë s'i ka menduar, por prapëseprapë me kalimin e vitit sikur kalojnë të gjitha, varrosen për të mos u kthyer më. Ky njeri i dobët, a nuk ka logjikë të ndalet e të mendojë se sa shumë njerëz ishin me të vitin e

kaluar dhe tashmë nuk janë më? Sa të tjerë janë sprovuar me sëmundje, por para një viti ishin në gjendje më të mirë? Sa të tjerë u varfëruan pas pa-surisë së madhe, e kështu me radhë...

Ndalu dhe pyete veten: Çfarë do të dëshironte shoku im nga ky vit i ri që na erdhi, po të ishte ende gjallë? A do shpresonte ashtu siç pati shpresuar çdoherë, të ketë kënaqësi të përkohshme, të kënaqë epshin, të shijojë botën, apo do të dëshironte diçka tjetër që kurrë nuk e posedoi? Çfarë dëshiron shoku im i sëmurë, i cili nuk mund të lëvizë nga shtrati prej dhembjeve? Të bëhet milioner, të dalë të bredhë rrugëve apo t'i

largohet sëmundja dhe të jetojë i qetë një jetë normale? Po ai që u varfërua, a i bie ndër mend për të varfrit tani që ka rënë në grackën e varfërisë apo ende bëhet mendjemadh dhe jeton me iluzionet e së kaluarës, ndërkohë që realiteti i tanishëm ia shtërëngon fytyrën çdo minutë?

O njeri i dobët, të bëj thirrje të ndalesh, të marrësh mësim, ngase koha dhe kalimi i shpejtë i saj është një mësim i madh për ty. Mendo një çast për mijëra vite që kanë kaluar para se ti të ishe në këtë botë dhe për qindra apo mijëra të tjerë që do të kalojnë, me lejen e Allahut, duke mos qenë ti prezent. A thua gjithë kjo kohë e kaluar dhe gjithë ajo që do të kalojë- në mesin e të cilave gjendesh ti për 60 apo 70 vjet, apo po e zëmë edhe 100 - nuk të zgjon nga gjumi që të kuptosh njëherë e përgjithmonë se duhet ta shfrytëzosh maksimalisht këtë kohë të shkurtër të kësaj jete, në mënyrë që të mos pendohesh në momentet e fundit para se t'ia dorëzosh shpirtin Allahut? Vetëdijesohu para se të të vetëdijesojë vdekja dhe të jetë vonë për çdo gjë. Ndalur që në fillim të këtij viti, merr një fletore dhe shëno të gjitha gabimet që ke bërë vitin e kaluar, në mënyrë që të largohesh prej tyre këtë vit. Dhe jo vetëm kaq, por duhet të mendosh edhe për punët e mira që nuk i ke bërë vitin e shkuar, që t'i bësh këtë vit dhe të kërkosht falje për atë që shkoi, kurse punët e mira që ke bërë t'i vazhdosh edhe këtë vit, madje me seriozitet dhe përpikëri më të madhe.

Nga tani paramendoje veten që nuk je më këtë vit, se vdiqe në vitin që lamë pas. Si do të dalësh para Allahut, me çfarë veprash të mira? Me namaz, zekat, agjërim, haxh, me adhurimet e tjera vullnetare, apo përveç mungesës së obligimeve je zhytur thellë edhe në mëkate dhe gabime?! Nëse do të ishe kështu vitin që shkoi, atëherë shpejto që mos të të kalojë edhe ky vit dhe të mбетesh në këtë gjendje. Shpejto para se të bëhet vonë!

Fillo dhe llogarit veten dhe përcakto qëllimin tënd: a dëshiron kënaqësinë e kësaj bote dhe të botës tjetër apo mjerimin e të dyjave? Ke ende mundësi të zgjedhësh njërën nga këto dy rrugë:

ose në xhennet ose në xhehennem.

Llogarite veten mirë, llogariti punët e tua si shitësi koprrac, përndryshe, deshe apo nuk deshe, dikush të përcjell dhe është duke llogaritur çdo gjë që del nga ti, qoftë edhe një fjalë goje.

Llogarite veten ngase vetëllogaritja është ilaçi i pakujdesisë tënde dhe vetëm atëherë do ta njohësh veten si kurrë më parë.

Dijetarët kanë treguar se vetëllogaritja bëhet në dy periudha. Periudha e parë është para veprimit të ndonjë veprë. Ndalur para se të punosh ndonjë punë të mirë dhe pyete veten: Përse po e bëj këtë punë, për ndonjë interes personal apo për hir të Allahut? Hasan el Basriu thotë: "Allahu e mëshiroftë atë njeri i cili ndalet para dëshirës për të vepruar diçka dhe shikon nëse e ka për hir të Allahut. Nëse po, e vazhdon. Nëse jo, kthehet mbrapa." Periudha e dytë është pas veprimit të veprës. Kjo është tre llojesh:

1. Të llogaritësh veten pas çdo ibadeti, se mos ndoshta ke lënë diçka mangët apo ke shtuar diçka që nuk është prej saj.

2. Të llogaritësh veten pas çdo veprë të cilën e ke pasur të ndaluar ta veprësh, në mënyrë që kjo llogaritje të të dërgojë në pendim dhe të vendosësh të mos kthehesh më në atë veprë të ndaluar.

3. Të llogaritësh veten në punët e lejuara, por jo adhurime në vetvete, se a do t'i bësh për Allah, që të shpërblehesh edhe në atë botë, apo të mjafton të marrësh fitimin e saj vetëm në këtë botë.

Askush nuk e di a do ta presë vitin e ardhshëm, kështu që le të shfrytëzojmë kohën dhe të punojmë punë të mira me të cilat do të dalim para Allahut, në atë ditë kur nuk do të bëjë dobi pasuria ose fëmijët, por zemra e pastër dhe veprat e duhura.

Lus Allahun e Madhërishëm të na mundësojë të veprojmë punë të mira, të llogarisim veten para se të na llogarisin dhe e lus Atë të na shpërblejë me xhennet, vendin e përgatitur për njerëzit e devotshëm!

*Në emër të redaksisë: Xheladin LEKA  
Zürich/Zvicërr*



# VLERA E TË QARËT NGA FRIKA E ALLAHUT

*Në një hadith tjetër, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Dy sy nuk i kaplon zjarri, syrin që ka lotuar nga frika e Allahut dhe syri që ka kaluar natën duke ruajtur si roje në rrugën e Allahut.”*

Allahu az-ze ve xhel-le thotë: “Dhe njëri-tjetrit i qasen duke pyetur (për punët e tyre në dunja). (Këta )Thonë: “Ne, edhe kur ishim në familjet tona, ishim ata që frikësoheshim. E Allahu na dhuroi të mira dhe na ruajti prej dënimit të erës (flakës) së nxehtë të zjarrit. Ne më parë ishim ndër ata që e lutëm Atë dhe Ai është Bami-rës, Mëshirues.”<sup>[1]</sup>

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Nuk do hyjë në xheben-nem ai njeri i cili qan nga frika e Allahut, derisa të kthehet qumështi nga gjiu që ka dal prej tij.”<sup>[2]</sup> Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-gjithashtu thotë: “Shtatë persona do të hyjnë nën hijen e Allahut të Madhëruar atë ditë kur

nuk do të ketë hije tjetër pos hijes së Tij. Ata janë: sundimtari (prijësi) i drejtë; i riu që është rritur në adhurim dhe i është nënshtruar Allahut; njeriu, zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë që nga dalja e saj e deri në ardhjen e sërishme për të falur namazin e radhës; dy njerëz që duhen mes vete, shoqërohen dhe ndahen për hir të Allahut; njeriu që vetmohet në ibadet e meditim dhe në vetmi duke përmendur Allahun i lotojnë sytë; njeriut që i vardiset një grua e bukur, por ai i përgjigjet “unë i frikësohem Allahut, Sunduesit të botëve” dhe njeriu që jep lëmoshë (sadaka) fshëhurazi, saqë dora e majtë nuk e di ç’jep e djathta.”<sup>[3]</sup> Në një hadith tjetër, Pejgamberi sal-lAllahu

[1] Et-Tur 25-28.

[2] Transmeton Tirmidhiu, nr. 1633.

[3] Transmeton Buhariu, nr. 629 dhe Muslimi 1031.

alejhi ve sel-lem thotë: “*Dy sy nuk i kaplon zjarri, syrin që ka lotuar nga frika e Allahut dhe syri që ka kaluar natën duke ruajtur si roje në rrugën e Allahut.*”<sup>[4]</sup>

Në një tjetër hadith, i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem thotë: “*Nuk ka gjë më të dashur tek Allahu sesa dy pika apo dy gjurmë: një pikë loti që del nga frika e Allahut dhe pika e gjakut që derdhet në rrugën e Allahut. Ndërsa dy gjurmët janë: një gjurmë në rrugë të Allahut dhe një gjurmë për kryerjen e obligimeve (farzeve) prej obligimeve të Allahut.*”

Abdullah ibën Umeri radijAllahu anhu ka thënë: “Të qaj nga frika e Allahut është më e dashur për mua sesa të jap lëmoshë një mijë dinarë.”

Ka'b el-Ahbari radijAllahu anhu është shprehur: “Të qarët nga frika e Allahut dhe xhenneti janë më të dashura për mua sesa të jap lëmoshë në ar sa peshoj vetë.”

## GJENDJA E MELAIKEVE

Transmetohet nga Enesi radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i ka thënë Xhibril: “*Ç’është me mua që asnjëherë nuk e shoh Mikailin duke qeshur?*” Tha: “*Nuk ka qeshur Mikaili prej atëherë kur është krijuar zjarri.*”<sup>[5]</sup>

## TË QARËT E PEJGAMBERËVE

Allahu i Lartësuar thotë: “*Këta (të përmendur) ishin që Allahu i gradoi nga Pejgamberët pasardhës të Ademit, prej pasardhësve të atyre që i patëm bartur (në anije) bashkë me Nuhun, prej pasardhësve të Ibrahimit dhe të Jakubit (israilët) dhe prej atyre që i udhëzuam dhe i bëmë të zgjedhur, kur u lexoheshin atyre ajetet e Zotit, binin në sexhde dhe qanin.*”<sup>[6]</sup>

## TË QARËT E PEJGAMBERIT

Transmetohet nga Abdullah ibën Mes’udi

radijAllahu anhu, i cili ka thënë: “*Më tha Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem: “Lexo prej Kur’anit.” Unë i thashë: “O i Dërguari i Allahut, të të lexoj ty Kur’an, kur ty të është shpallur?” Ai tha: “Unë kam dëshirë që të dëgjoj prej dikujt tjetër.” Kështu që fillova të lexoja nga surja En-Nisa, deri kur arrita tek ajeti: “Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull dhe ty do të të sjellim dëshmitar mbi ata (që nuk besuan).”<sup>[7]</sup>*

Atëherë më tha: “*Mjafton me kaq.*” Kur unë pastaj e drejtova shikimin te Pejgamberi, pashë se nga sytë e tij kishin dalë lot.”

Abdullah ibën Eshihiri radijAllahu anhu thotë: “*Erdha tek Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe ai ishte duke falur namaz, kurse gjoksi i Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem gumëzhinte si kazan (tenxhere) nga të qarët.*”

Nga Ubejd ibën Umejri radijAllahu anhu transmetohet se i kishte thënë Aishes radijAllahu anha: “Na trego për atë që ke parë te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe që të ka çuditur më shumë...”

Ubejdi tha: “Heshti (Aishja) një çast e pastaj tha: “*Një natë prej netëve, i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem më tha: “O Aishe, më lejo ta kaloj këtë natë në ibadet (adhurim) ndaj Allahut.” I thashë: “Pasha Allahun, unë dua të jem pranë teje.” Më pas Aishja radijAllahu anha shtoi: “Pastaj u ngrit, u la dhe filloi të falej.” Aishja radijAllahu anha tregon se ka qarë derisa i është lagur prehri. Ishte ulur dhe vazhdoi të qante derisa iu lag mjekra. Vazhdoi të qante derisa u lag edhe toka! Pastaj erdhi Bilali radijAllahu anhu për të thirrur ezanin për namaz dhe kur e pa Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke qarë, i tha: “O i Dërguari i Allahut, po qan kur Allahu t’i ka falur mëkatet e mëparshme dhe të mëvonshme?!” Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-*

[4] Transmeton Tirmidhiu, nr. 1639 dhe shejh Albani thotë se hadithi është i saktë.

[5] Transmeton Ahmedi dhe shejh Albani thotë se hadithi është i mirë.

[6] Merjem: 58.

[7] En-Nisa: 41.

lem tha: *“A të mos jem rob falënderues?! Allahu ka zbritur në këtë natë një ajet, mjerë për atë që e lexon dhe nuk mediton për të! Allahu thotë: “Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt.”*”<sup>[8][9]</sup>

## TË QARËT E SAHABËVE

Transmetohet nga Enesi radijAllahu anhu, i cili ka thënë: “Mbajti Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem një fjalim dhe nuk kam dëgjuar asnjëherë fjalim më të mirë se ai, në të cilin tha: *“Po të dini atë që di unë, do të qani shumë e do të qeshni pak.”* I mbuluan shokët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem fytyrat e tyre dhe dëgjoheshin zërat e të qarët.”

Uthmani radijAllahu anhu, kur është ndalur para varrit, ka qarë aq shumë, derisa i është lagur mjekra. Atëherë i thoshin të tjerët: “E përkujton xhennetin dhe xhehennemin e nuk po qan, kurse prej varrit po të vjen të qash?” Ai tha: “Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Varri është vendi i parë prej vendeve të ahiretit, nëse shpëton prej tij, atëherë ç’të vijë pas tij do të jetë më e lehtë. E nëse nuk shpëton prej tij, atëherë ç’të vijë pas tij do të jetë më e vështirë.”* Dhe ka thënë: *“Nuk kam parë pamje më të tmerrshme se pamja e varrit.”*”<sup>[10]</sup>

Muadhi radijAllahu anhu ka qarë aq shumë, saqë lotët i rridhnin nëpër mjekër. E pyetën se pse po qante dhe ai u përgjigj: “Allahu i rrëmben njerëzit me dy rrëmbime, një për në xhennet dhe tjetra për në zjarr, kurse unë nuk e di se te cila do të jem.”

Transmetohet nga Temim ed-Darij radijAllahu anhu, se ka lexuar ajetin: *“A menduan ata, të cilët vepruan në të këqija, se në jetën e tyre dhe në vdekjen e tyre do t’i bëjmë të*

*barabartë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira? Sa i shëmtuar është gjykimi i tyre!”*<sup>[11]</sup> E ka përsëritur deri në mëngjes dhe ka qarë. Ibën Umeri radijAllahu anhu filloi të lexonte suren El-Mutafifin dhe kur arriti tek ajeti: *“Në ditën kur njerëzit ngrihen (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve...”*, filloi të qante dhe nuk mundi të vazhdonte.

## TË QARËT E TË PARËVE TANË (SELEFËVE)

Është pyetur Ataë ibën es-Sulejmij pse ishte i pikëlluar. Ai tha: “Mjerë për ty, vdekja është mbi qafën time, varri është shtëpia ime, në Ditën e Gjykimit është qëndrimi im, mbi urën e xhehennemit rruga ime dhe nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua!”

Një njeri i lexoi Umer ibën Abdul Azizit ajetin: *“E kur të hidhen duarlidhur në një vend të ngushtë, aty do të kërkojnë shkatërrimin (vetëzhdukjen).”*<sup>[12]</sup> Filloi të qajë, u ngrit dhe shkoi në dhomë, kurse njerëzit u shpërndanë.

Një natë prej netëve, El-Haseni filloi të qajë dhe bashkë me të u ngritën zërat e anëtarëve të familjes nga të qarët. Pyetën për gjendjen e tij dhe ai tha: “Kujtova një mëkat që kam bërë dhe më erdhi për të qarë.”

Vëllezër, kjo ishte gjendja e të parëve tanë. E lusim Allahun az-ze ve xhel-le që zemrat tona të rrëqethen kur të përmendet Emri i Tij dhe sytë tanë gjithmonë të lotojnë nga frika e Allahut të Madhëruar!

Marrë nga: [www.saaaid.net](http://www.saaaid.net)

Përmbledhi dhe përshtati: Fehmi DALIPI

Mekke/Saudi


[8] Alu Imran: 190

[9] Transmeton Ibën Hibani 386/2, shejh Albani thotë se hadithi është i mirë

[10] Transmeton imam Ahmedi, nr. 456; Tirmidhiu, nr. 2308; Ibën Maxheh, nr. 4267. Shejh Albani thotë se hadithi është i mirë.

[11] El-Xhathijeh: 21.

[12] El-Furkan: 13.



# MOS U ZEMËRO!

*I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "...Mos u lutni kundër vetes suaj, mos u lutni kundër fëmijëve tuaj dhe mos u lutni kundër pasurisë suaj, ngase ndodh të miratoheni nga Allahu dhe t'ju pranohet lutja."*

Shpeshherë dëgjojmë për probleme dhe zënka, armiqësi dhe përçarje, prishje raportesh dhe madje edhe mes atyre që kanë lidhje farefisnore ose lidhje të ngushta familjare.

Shumë vrasje dhe tentimvrasje vijnë pas një zënkë të vogël, e cila nuk mbyllet me aq por i tejkalon kufijtë duke shkuar deri te vrasja apo hakmarrja. Por a jemi ndalur ndonjëherë të mendojmë se pse një zënkë e vogël mund të rezultojë me vrasje apo konfrontim fizik? Çfarë është ajo që raportet nga miqësore dhe vëllazërore i shndërron në armiqësore dhe të padëshiruara? Kush ndalet dhe sheh ngjarjet dhe ndodhitë që ndodhin në vende dhe mjedise të ndryshme, konfrontimet e ndryshme dhe shkaqet e tyre, vëren se shkak kryesor është zemërimi i menjëhershëm dhe mospërmbytja. Zemërimi dhe mlllefosja në shumicën e rasteve është ajo që e shndërron një lidhje nga miqësore dhe vëllazërore në armiqësore dhe të paqëndrueshme.

Ibën Kajim el-Xhevzije, Allahu e mëshiroftë, shprehet: "Shtyllat e mosbesimit (kufrit) janë katër: mendjemadhësia, zilia, zemërimi dhe epshi. Mendjemadhësia e pengon (njeriun) nga nënshtrimi (për Zotin), zilia e pengon atë nga

pranimi i këshillës dhe dhënia e saj, zemërimi e pengon nga drejtësia dhe epshi e pengon nga adhurimi. Nëse zhduket shtylla e mendjemadhësisë, i lehtësohet nënshtrimi (ndaj Krjuesit); nëse zhduket shtylla e zilisë, i lehtësohet pranimi i këshillës dhe këshillimi; nëse zhduket ajo e zemërimit, i lehtësohet drejtësia dhe modestia dhe nëse zhduket shtylla e epshit, i lehtësohet durimi, pastërtia (shpirtërore) dhe adhurimi."<sup>[1]</sup>

Kjo thënie është plotësisht e drejtë, kur kemi parasysh se zemërimi e largon mendjen dhe fenë nga roli dhe ndikimi i tyre në njeriun dhe nuk i lë njeriut hapësirë për arsyetim, mendim dhe zgjidhje. Zemërimi e verbon dhe e shurdhon atë ndaj çdo lloj këshille dhe përkujtimi. Ai e bën njeriun që të veprojë sjelljet dhe veprimet e të çmendurve, saqë po ta shikonte njeriu veten dhe formën e tij, nuk do t'i pëlqente. Zemërimi e shtyn njeriun në vepra të ndaluara dhe të rrezikshme, për të cilat nuk mbetet hapësirë dhe shans për pendim, edhe po të dëshironte ta bënte një gjë të tillë...! Zemërimi e bën njeriun që qielli t'i duket tokë dhe toka qiell. Ai e shpie njeriun te mëkatet më të mëdha: mosbesimi

[1] "El-Fevaid", Ibën Kajjim, "Darul Kutub el-Ilmijje", faqe 57.

dhe (vetë)vrasja. . .

I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve se-lem tregon se “një njeri (nga popujt e lashës), i cili ishte nga ata që adhuronin Zotin, i kishte thënë një tjetri i cili ishte i zhytur në mëkat: “Vallahi, nuk do të të falë ty Allahu kurrë!” Atëherë Zoti tha: “Kush është ai që betohet në Mua që mos ta fal dikë?! (Dhe tha): “Ja fala atij dhe ty t’i prisha veprat (e tua).”<sup>[2]</sup> Ky person është zemëruar (ndoshta) me të drejtë dhe për shkak të xhelozisë ndaj fesë së Zotit, por kishte hyrë në kompetencat e Zotit duke gjykuar me diçka që s’i takonte. Pas kësaj, Zoti ia kishte shkatërruar veprat e tij të mira, ndërsa në të njëjtën kohë kishte zbritur mëshirë për të parin. Kjo ndodhi sepse Zoti dënon dhe mëshiron, shpërblen dhe privon, fal dhe gjykon. E, kush tjetër përveç Tij mund ta bëjë këtë?! Për këtë arsye, Ebu Hurejra radijAllahu anhu i paralajmëronte ata të cilët i sfidonin njerëzit me një dënim të tillë për shkak të zemërimit të tyre, edhe nëse në atë rast kishin të drejtë. E si është puna me ata që nuk kanë fare të drejtë, që zemërohen jo pse shkelen dispozitat e Zotit, por për shkak se kundërshtohen ata dhe për këtë arsye dëshirojnë të hakmerren dhe me zbrazjen e mllëfit “të shërohen”?!

Transmetohet nga Imran ibën Husajni radijAllahu anhu se ai me disa shokë të tjerë ishin me të Dërguarin e Allahut sal-lallahu alejhi ve se-lem në një udhëtim të tyre dhe një grua nga ensarët ishte mbi devenë e saj. Ajo u zemërua me të dhe e mallkoi. E dëgjoi i Dërguari i Zotit sal-lallahu alejhi ve se-lem dhe tha: “Merreni atë (barrën) që është mbi të dhe lëreni atë të lirë sepse është e mallkuar.”<sup>[3]</sup>

Kjo grua e humbi devenë e saj dhe iu ndalua të përfitojë prej saj, madje edhe të hipte mbi të, për shkak të një fjale, një mallkimi, i cili erdhi nga zemërimi dhe hidhërimi i saj. I Dërguari i Zotit sal-lallahu alejhi ve se-lem e urdhëroi ta linte të lirë devenë e saj sepse nuk pranoi të udhëtonte me një deve të mallkuar dhe me këtë dëshiroi të edukonte ummetin e tij se mallkimi nuk është shërim i zemërimit, por pasojë dhe rezultat i keq i tij.

I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve se-lem ka thënë: “. . .Mos u lutni kundër vetes suaj, mos u lutni kundër fëmijëve tuaj dhe mos u lutni kundër pasurisë suaj, ngase ndodh të miratoheni nga Allahu dhe t’ju pranohet lutja.”<sup>[4]</sup> “Mos u lutni” në këtë hadith ka për qëllim lutje për të keq, hakmarrje dhe shkatërrim, sepse mund të ndodhë të koinçidojë lutja me kohën e pranimit të saj dhe të pranohet.

Lexues i nderuar!

Tashmë e pe se ç’ndodh kur personi zemërohet, se si gjuha i paraprin kokës dhe logjikës së tij, kështu që veprimet të tilla pa dyshim që paraqesin dobësi dhe jomencëuri e asses fuqi

dhe trimëri. Nëse ti (në rast zemërimi) do ta kishe ndaluar veten, do ta kishe shtrënguar dhe stopuar gjuhën, do t’i kishe ndaluar gjymtyrët nga çdo lloj veprimi të pamatur, atëherë do të kishe hyrë në grupin e të fuqishmëve, të diturve dhe të maturve, madje me dëshminë e vetë të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve se-lem, i cili thotë: “Nuk është i fortë ai që i mund njerëzit, por i fortë është ai që e përmban veten kur zemërohet.”<sup>[5]</sup> Po ashtu, në “Sahihun” e Muslimit qëndron (nga Abdullah ibën Mes’udi radijAllahu anhu) se i Dërguari i Allahut i kishte pyetur shokët e tij: “Çfarë llogaritni fuqi të ju?” Ata thanë: “Atë që njerëzit nuk arrijnë ta mundin.” Dhe ai tha: “Jo, nuk është kjo, por (i fortë llogaritet) ai që e përmban veten kur zemërohet.”<sup>[6]</sup>

### Paralajmërimi i të Dërguarit të Zotit për zemërimin

Transmeton Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, nga hadithi i Abdullah ibën Amrit, i cili e kishte pyetur të Dërguarin sal-lallahu alejhi ve se-lem duke thënë: “Çfarë më largon mua nga hidhërimi i Zotit të Plotfuqishëm?” Ai i tha: “Mos u zemëro.”<sup>[7]</sup> Edhe në “Sahihun” e Buhariut qëndron se një njeri i kishte thënë të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve se-lem: “Më porosit (më këshillo), ndërsa ai i kishte thënë: “Mos u zemëro.” E kishte ripërsëritur disa herë (kërkesën për këshillim) dhe i Dërguari prapë i kishte thënë: “Mos u zemëro.”<sup>[8]</sup> Tek hadithi i parë miratimi i pyetjes nga ana e të Dërguarit tregon për rrezikshmërinë e zemërimit. Duke iu përgjigjur pyetjes se “çfarë më largon mua nga hidhërimi i Zotit”, ai i ka sqaruar se ajo që të largon është moszemërimi dhe ruajtja prej tij. E kundërta, praktikimi dhe realizimi i zemërimit, është shkak për hidhërimin e Zotit. E si të mos jetë shkak kur dihet mirë se shumë probleme, mëkate, përçarje dhe shkatërtime, zënka dhe keqkuptime, vrasje dhe armiqësi janë rezultat dhe pasojë e zemërimit! Xhafer ibën Muhamedi thoshte: “Zemërimi është çelësi i gjithë të keqjave.”<sup>[9]</sup> Gjithashtu, sahabi i cili i kërkoi të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve se-lem që ta këshillonte, duke e ripërsëritur kërkesën e tij, merret vazhdimisht si përgjigje këshillën “mos u zemëro”. Kjo e tregon shumë qartë rrezikshmërinë e zemërimit, i cili është esenca e çdo të keqeje dhe se ruajtja prej tij është esenca e çdo të mire, ngase hidhërimi i Zotit nuk vjen për shkak të veprave të mira. . .

### Metodat e parandalimit të zemërimit

Kur flasim për metodat preventive të hidhërimit, duhet të themi se këto metoda janë dy llojesh, ashtu siç ka shkruar Ibën Rexhepi, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij “Xhamiul

[2] “Sahihul-xhami”, nr. 2075.

[3] “Sahih Muslim”, nr. 2595

[4] “Sahih Muslim”, nr. 3009.

[5] Buhariu (nr. 6114) dhe Muslimi (nr. 2609).

[6] Muslimi, nr. 2608.

[7] Ahmedi (2/175), hadithi është hasen.

[8] Buhariu (nr. 6116).

[9] “Xhamiul Ulumi wel Hikem”, Ibën Rexheb, Darul Fexhr, Kajro, faqe 236.

Ulumi vel Hikem”. Metoda e parë ka të bëjë me marrjen e masave dhe parandalimin e ndodhjes së zemërimit dhe bëhet duke treguar maturi dhe durim, përmbajtje dhe qëndrim. Kurse metoda e dytë është ajo e cila e parandalon zemërimin (pas rënies në të) që të shkaktojë ndonjë veprë të padëshiruar, pra ka të bëjë me parandalimin e rezultateve negative dhe shërimin e shpejtë të tij. Në vijim do të flasim pak më gjerësisht për këto dy metoda dhe degëzimet e tyre.

A. 1-Lloji i parë: “Mos u hidhëro” në kuptimin (e parë) që do të thotë se nga besimtari kërkohet dhe është më se e domosdoshme të pajiset me edukatë dhe moral të lartë, të jetë i ruajtur dhe i matur, të falë dhe të tejkalojë, të jetë durimtar dhe i aftë, mendjemprehtë dhe i arsyeshëm, që ta fusë mendjen në përdorim para çdo lloj veprimi, të dijë të dallojë çdo veprim se çfarë sjell dhe cilat mund të jenë pasojat e tij... Për këtë pa dyshim që ndihmon shumë sistemi i adhurimit të besimtari; nëse ai është i edukuar me adhurim ndaj Zotit, në falë dhe veprë, është i lidhur me obligimet ditore dhe parësore të tij, atëherë një gjë e tillë e ndihmon të jetë i aftë, ta ruajë jo vetëm gjuhën e tij nga çdo lloj fjale dhe shprehjeje e keqe, por edhe dorën e tij nga çdo lloj veprimi si pasojë e zemërimit.

I është thënë Ibën Mubarekut, Allahu e mëshiroftë: “Na e defino moralin e mirë në një fjalë.” Ai tha: “Moszemërimi.” Shumë dijetarë të tjerë e kanë definuar moralin e mirë me lënien e zemërimit.<sup>[10]</sup> Prandaj nga kjo kuptojmë që besimtari në esencë duhet të jetë i edukuar që në radhë të parë të mos zemërohet dhe mos ta bëjë moral dhe edukatë të tij zemërimin pas çdo fjale që dëgjon apo veprimi që përjeton... Argumentet për këtë nga jeta e të Dërguarit sal-Lallahu alejhi ve sel-lem janë të shumta, por ne do të cekim një nga to: “*U ankuan tek i Dërguari i Zotit për imamin i cili e zgjaste namazin, për shkak se disa vonoheshin për në namaz (dhe kështu mund ta zinin namazin me imam). I Dërguari u hidhërua tej mase dhe kjo u dallua në fytyrën e tij. U ngrit, i këshilloi njerëzit dhe i urdhëroi (imamet) për lehtësim ndaj njerëzve.*”<sup>[11]</sup> Nga kjo vërehet se me gjithë zemërimin e tepërt (në këtë rast) të të Dërguarit të Allahut, ai nuk e thirrte imamin që të merrte hak dhe as që dha ndonjë urdhër (të ashpër) për të, por u ngrit para njerëzve, i këshilloi ata dhe porositi që kur imami të falet me njerëz, le t’ua lehtësojë atyre namazin dhe mos ta zgjasë atë.

2- Që zemërimi të jetë për Zotin dhe në rast se shkelen dispozitat e fesë së Tij dhe të mos jetë për epsh apo dëshirë për hakmarrje për shkak të cënimit apo dëmtimit të dëshirave ose interesave të tij. Kjo bëhet kur njeriu kupton dhe e njeh mirë shpirtin e tij dhe e di se nuk meriton që të hakmerret për tekat apo epshet e tij. I tillë ishte i Dërguari i Allahut sal-Lallahu alejhi ve sel-lem. Ai nuk zemërohej për t’u hakmarrë për veten e tij, por zemërohej dhe hidhërohej për shkak të

cenimit dhe shkeljes së dispozitave të Zotit xhel-le xhel-laluhu.

Nëse zemërimi ndodh për shkak të hakmarrjes së personit për veten e tij, atëherë ai do të jetë në gjendje t’i gjejë të gjitha format dhe nuk do të njohë as pengesë as parim, por do të përpiqet me çdo kusht që ta “shërojë” mllëfin e tij, edhe nëse do t’i kushtojë shtrënjtë. Por nëse ai zemërohet për shkak të shkeljes së dispozitave të Zotit, atëherë do ta gjejë mënyrën e përshtatshme për ta shëruar dhe zgjidhur atë problem ngase ajo që është tek Allahu (shpërblimi) nuk arrihet me hidhërimin e Tij, por me hidhërimin për Të. Këtë më së miri e ilustron shembulli i sipërcekur, me rastin e zemërimit të të Dërguarit për zgjatjen e imamit në namazin e tij... Po ashtu, një herë i Dërguari i Zotit sal-Lallahu alejhi ve sel-lem hyri tek dhoma e Aishes radijAllahu anha dhe pa një perde me fotografi. I ndryshoi ngjyra e fytyrës (nga hidhërimi), u skuq dhe tha: “Vërtet njerëzit me dënimin më të rëndë (në) Ditën e Gjykimit janë ata që i pikturojnë këto piktura.”<sup>[12]</sup> Në rastin në fjalë, vërejmë se i Dërguari i Zotit sal-Lallahu alejhi ve sel-lem pas hidhërimit nuk reagoi ashpër, por ofroi një këshillë duke mësuar Aishen (por edhe besimtarët në përgjithësi) për dispozitën e mbajtjes dhe pikturimit të pikturave, ndërsa Aishja radijAllahu anha ishte ajo që më vonë i largoi dhe i shkatërroi ato piktura. Nëse e kuptojmë mirë këtë, do të vërejmë gabimet e disa të rinjve muslimanë, të cilët duke qenë xhelozë ndaj dispozitave të Zotit dhe shkeljes së tyre i marrin gjërat me eufori dhe vrull, duke mos menduar mirë për rezultatet e mëvonshme. Ata nisen me dhunë duke u munduar që problemin ta zgjidhin menjëherë dhe me dorë, si rasti i grindjes me ndonjë familjar për shkak se ai nuk respekton ndonjë dispozitë të caktuar të Islamit, p.sh. pirja e duhanit apo dëgjimi i muzikës, duke rezultuar ndoshta me thyerjen e radios apo TV-së në shtëpi, etj.

3- Duaja. Lutja dhe drejtimi nga Zoti duke kërkuar nga Ai që të të ndihmojë ta mundësh zemërimin dhe të fitosh kundër tij.

I Dërguari i Allahut sal-Lallahu alejhi ve sel-lem shpesh lutej duke thënë: “*O Zot, Ty të kërkoj që të ma mundësosh (ta them) fjalën e drejtë, kur jam i zemëruar dhe i kënaqur.*”<sup>[13]</sup> Ky pa dyshim se është një rezultat i mirë dhe i çmuar, ngase fjala me peshë më të madhe është nëse thuhet ashtu siç qëndron edhe kur je i zemëruar apo kur nuk është në interesin tënd. Kështu porosiste i Dërguari i Allahut sal-Lallahu alejhi ve sel-lem dhe për të dëshmon Ebu Dherri radijAllahu anhu, i cili thotë: “*Më ka urdhëruar (porositur) i Dashuri i Zotit sal-Lallahu alejhi ve sel-lem me shtatë (gëra) dhe ndër to ceku: “...që ta them të vërtetën edhe nëse është e hidhur...”*”<sup>[14]</sup>

Suksesi më i madh për një musliman të zemëruar dhe të

[10] Po aty.

[11] Muttefekun alejhi (Buhariu nr. 6110, Muslimi nr. 466).

[12] Muttefekun alejhi (Buhariu nr. 6109 dhe Muslimi nr. 2107).

[13] Nesaiu nr. 1305 dhe Ahmedi 4/264.

hidhëruar është kur thotë të vërtetën dhe nuk e shtrembëron edhe nëse zemërimi i tij e fton për diçka tjetër. Veprimi i saktë dhe i drejtë në rast zemërimi është fitore ndaj tij, përndryshe ai (zemërimi) nuk e justifikon atë veprim në asnjë formë dhe për këtë i Dërguari i Zotit sal-Allahu alejhi ve sel-lem i porosiste gjykatësit duke thënë: *“Mos të gjykojë asnjë gjykatës (mes dy personave) duke qenë i zemëruar.”*<sup>[15]</sup>

B. Lloji i dytë: “Mos u zemëro” në kuptimin e dytë do të thotë që nëse ndodh zemërimi apo dikush e shkakton atë, atëherë mer masat e duhura preventive për ndalimin dhe tejkalimin e tij, duke evituar pasojat negative që mund të rezultojnë në këtë rast. I Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem na mëson shkëlqyeshëm se si mund të arrihet kjo. 1. Ndryshimi i formës dhe gjendjes fizike në të cilën gjendet ai që zemërohet.

Profeti i Zotit thotë: *“Nëse zemërohet dikush prej jush dhe është në këmbë, le të ulet. Nëse largohet zemërimi (mirë), në të kundërtën le të shtrihet.”*<sup>[16]</sup> Ai që e shikon këtë thënie profetike me një sy studimi dhe me një vështrim përfuturi kupton se është me të vërtetë zgjidhje e problemit dhe shërim i sëmundjes së zemërimit sepse kur dikush zemërohet dhe është i ngritur në këmbë, atëherë është shumë i përgatitur dhe afër realizimit të asaj që e fton zemërimi i tij. Por nëse ai kujton (shpejt) dhe ulet pa dyshim se kjo e ndihmon që t'i largohet apo pakësohet zemërimi sepse gjaku pushon dhe ngadalëson së lëvizuri, kurse mundësitë për hakmarrje janë shumë më të vogla (në krahasim me atë që është në këmbë). Nëse shtrihet, atëherë çdo mundësi dhe shans për hakmarrje nuk ekziston. Transmetohet nga Ebi Seid el-Hudriu se i Dërguari i Zotit sal-Allahu alejhi ve sel-lem kishte thënë: *“Vërtet zemërimi është zjarr në zemrën e birit të Ademit. A nuk keni parë (kur dikush zemërohet) në skuqjen e syve të tij dhe fryrjen e nofullave të tij, prandaj nëse dikush përjeton diçka nga kjo le të shtrihet për tokë.”*<sup>[17]</sup>

3. Parandalimi i efekteve dhe rezultatit që mund të sjellë zemërimi duke përmendur Zotin e Madhërishtëm. Në librin e Buhariut dhe Muslimit, Sulejman bin Suredi qëndron se ka thënë: *“U ofenduan dy njerëz në prezencën e të Dërguarit të Zotit dhe ne ishim ulur dhe ashtu njëri nga ata i zemëruar dhe i skuqur në fytyrë (vazhdonte të) ofendonte. Atëherë i Dërguari tha: “Unë e di një fjalë që nëse e thotë, do të ikë zemërimi që ai përjeton. Sikur të thotë eudhubil-lahi minesh-shejtani-rraxhim (i mbështetem Allahut që të më ruajë nga djalli i mallkuar).” Dhe ne i thamë atij njeriu: “A nuk dëgjon çfarë thotë i Dërguari i Allahut?!” Ai tha (ashtu i*

*zemëruar): “Unë nuk jam i çmendur.”*<sup>[18]</sup> D.m.th. ky njeri nuk e ka sfiduar zemërimin dhe as i ka marrë masat e duhura që ta mundë atë, por ka refuzuar të thotë fjalën që do t'i kishte larguar zemërimin dhe kështu u ka ngjarë të çmendurve, edhe pse ai mendonte se nuk ishte i tillë. Gjendja e tij në fakt dëshmoi të kundërtën.

Përmendja e Zotit, lexues i dashur, është “shpatë e mprehtë” kundër shejtanit të mallkuar dhe asaj për të cilën ai nxit. Nëse e ke bindjen se djalli i mallkuar është burimi i të gjitha të këqijave dhe fatkeqësive, atëherë bindu se largimi dhe të përzënia e tij nga vendi ku gjendesh është shpëtim, ruajtje dhe siguri. A nuk ke dëgjuar fjalën e të Dërguarit të Allahut, i cili thotë: *“Mos i bëni shiëpitë tuaja varreza sepse vërtet shejtani ikën nga ajo shiëpi në të cilën lexohet sureja el-Bekare.”*<sup>[19]</sup> Muslimi në “Sahihun” e tij, në kapitullin “Mirësia e ezanit dhe ikja e shejtanit me dëgjimin e tij”, transmeton nga Suhejl ibën ebi Salih, nga i Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem, i cili ka thënë: *“Kur të thirret (ezani) për namaz, shejtani ikën.”*<sup>[20]</sup>

Kështu, nëse muslimani ruan veten, gjuhën, mendjen dhe gjymtyrët e tij, i ka nën kontroll veprimet e tij, zbaton shkaqet dhe masat se si të ruhet që të mos dalë nga kontrollimi i vetvetes, e sfidon zemërimin dhe nuk e realizon atë në të cilin ai e fton, do të arrijë një gradë të cilën shumëkush do ta kishte zili. Nëse arrin të jetë i tillë, i sfidon dhe i mposht epshet dhe tekat e tij, të cilat nëse do të pasoheshin verbërisht dhe pa kontroll do ta shpinin në një humnë nga e cila vështirë se do arrinte të dilte (ndonjëherë) dhe pa pasoja. Nëse ai sfidon zemërimin e tij, hyn në grupin e besimtarëve të cilët Zoti në Kur'anin Famëllartë i lavdëron duke i cilësuar si bamiirës. Thotë i Lartësuar: *“...dhe (të cilët) e frenojnë mllëfin (zemërimin), që u falin (të keqen) njerëzve dhe (vërtet) Allahu i do bamiirësit.”*<sup>[21]</sup> Kur i lavdëron besimtarët thotë: *“Dhe ata (të cilët) u shmangen mëkateve të mëdha e të shëmtuara dhe kur hidhërohen (zemërohen), ata falin.”*<sup>[22]</sup> I Dërguari i Zotit sal-Allahu alejhi ve sel-lem i përgëzon ata që nuk e realizojnë mllëfin e tyre, por e mbajnë atë duke thënë: *“Kush e frenon mllëfin duke qenë se ka mundësi ta realizojë atë, do ta thërrasë atë Allahu në Ditën e Gjykimit në prezencën e të gjitha krijesave, derisa ta lërë të zgjedhë nga cila hyri e shenitetit të dëshirojë.”*<sup>[23]</sup>

Mr. Selatin MEHANI  
Ammani/Jordani

[14] Ahmedi 5/159, hadithi është hasen, shiko “Es-silsiletus-Sahiha”, hadithi nr. 2166.

[15] Buhariu, nr. 7185 dhe Muslimi nr. 1717.

[16] Ahmedi 5/152, Ebu Davudi 4782.

[17] Ahmedi 3/19, dhe Tirmidhiu 2191, hadithi është hasen.

[18] Muttefekun alejhi (Buhariu nr. 6115, Muslimi nr. 10/26).


[19] Muslimi 780.

[20] Muslimi nr. 389.

[21] Ali Imran: 134.

[22] Esh-Shura: 37.

[23] Ahmedi 3/440 dhe Tirmidhiu nr. 2021.



# PARATHËNA E “SUNENIT” TË IBËN MAXHES LIBRI MBI SUNNETIN

(KAPITULLI I PESTË : “KUSH FLET NDONJË HADITH NGJA I DËRGUARI I ALLAHUT, NDËRSA AI (HADITH) MENDOHEË TË JETË GËNJESHTËR.”

*I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “...Mos u lutni kundër vetes suaj, mos u lutni kundër fëmijëve tuaj dhe mos u lutni kundër pasurisë suaj, ngase ndodh të miratoheni nga Allahu dhe t’ju pranohet lutja.”*

## HADITHI NR. 38

Transmetohet nga Aliu radijallahu anhu dhe ai nga i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të ketë thënë: “Kush flet një hadith nga unë dhe mendohet të jetë gënjeshërë, ai është njëri nga dy gënjeshtarët.”

## HADITHI NR. 39

Transmetohet nga Semure ibën Xhundeb dhe ai nga i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të ketë thënë: “Kush flet një hadith nga unë dhe mendohet të jetë gënjeshërë, ai është njëri nga dy gënjeshtarët.”

## HADITHI NR. 40

Transmetohet nga Aliu radijallahu anhu, nga i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të ketë

thënë: “Kush transmeton nga unë një hadith dhe ai (hadith) mendohet të jetë gënjeshërë (ndaj meje), personi i tillë është njëri nga dy gënjeshtarët.”

## HADITHI NR. 41

Transmetohet nga el-Mugiretu ibën Shu'be të ketë thënë: “Ka thënë i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “Kush flet nga unë një hadith duke e ditur se është gënjeshërë, ai është njëri prej dy gënjeshtarëve.”

Sqarim

Këtë hadith e transmeton Imam Muslimi në parathënien e “Sahihut” të tij dhe dihet nga dijetarët e hadithit se hadithet që Imam Muslimi i ka përmendur në parathënien e “Sahihut” nuk janë

të shkallës së njëjtë me hadithet që ka përmendur brenda në libër. Për këtë arsye është e domosdoshme edhe nga përgjegjësia shkencore që nëse ndokush përmend një hadith të cilin Muslimi e ka transmetuar në parathënie, ta theksojë se është përmendur në parathënie dhe të mos thotë vetëm se e transmeton Muslimi.

Mirëpo ky hadith është i saktë. Imam Muslimi ka thënë: "Siç ka ardhur në "etherin e njohur", hadithin gjithashtu e transmeton Tirmidhiu me nr. 2662 dhe thotë hasen sahih. Gjithashtu e transmeton ibën Maxheh me nr. 38, 39, 40, 41.

Dijetar Albani hadithin e konsideron të saktë, autentik.

*Shqiptimi dhe drejtshkrimi i disa fjalëve në hadith*  
Për fjalën "ve huve jura" imam Neveviu thotë se folja "jura" shqiptohet në dy mënyra: "jura" që ka kuptimin "mendohet të jetë" dhe "jera" që ka kuptimin se "ai e di".

Për fjalën "fe-huve ehadul-kadhibejni" (ai është njëri nga dy gënjeshtarët), Kadi Ijadi thotë se tek ne transmetimi është në shumës, d.m.th.: "ehadul-kadhibine" që d.m.th. "ai është njëri nga gënjeshtarët".

Ndërsa Ebu Nuajmi e ka transmetuar në librin e tij "El-mustahrexh ala sahihi Muslim" në dyjës "ehadul-kadhibejni", që d.m.th. "ai është njëri nga dy gënjeshtarët", duke e arsyetuar këtë se transmetuesi i cili e di se hadithi është i pavërtetë vetëm se e ka shoqëruar në mëkat personin që e ka shpikur këtë hadith. Shohim pra se dijetarët hadithin e kanë shqiptuar në të dy mënyrat dhe secila e ka kuptimin e vet dhe nuk bien ndesh njëri me tjetrin.

### *Mësimet nga ky hadith*

Hadithi tregon se sa i rrezikshëm është ekspozimi në transmetimin e fjalëve të të Dërguarit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, duke treguar se nëse transmetuesi mendon apo e di se hadithi në fjalë është gënjeshtër dhe e transmeton atë, ai konsiderohet njëri nga gënjeshtarët. Këtu është për qëllim njëri nga gënjeshtarët në hadithet e të Dërguarit sal-


lAllahu alejhi ve sel-lem, kur dihet fare mirë mëkati i madh i atij që gënjen ndaj të Dërguarit. I kemi radhitur më herët hadithet që tregojnë për rrezikun e madh për atë që gënjen ndaj të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, si p.sh.: "*Kush gënjen ndaj meje me qëllim, le t'ia përgatisë vetes ulësen prej zjarrit.*" Gjithashtu, i Dërguari sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka treguar se gënjeshtër ndaj tij nuk është e njëjtë me gënjeshtër ndaj dikujt tjetër. Transmeton Muslimi në parathënie e tij nr:5, nga i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të ketë thënë: "*Me të vërtetë gënjeshtër ndaj meje nuk është sikurse gënjeshtër ndaj dikujt tjetër; ai që gënjen ndaj meje me qëllim le t'ia përgatisë vetes vendin e tij në zjarr.*"

Në numrin 19 të revistës kemi folur më gjerësisht për rrezikun dhe gjurmët e gënjeshtres ndaj të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Nga hadithi mësojmë se ai që me argumente mendon apo e di se hadithi është jo i saktë dhe në të njëjtën kohë e transmeton duke mos e sqaruar se hadithi nuk është i vërtetë, ai në këtë rast konsiderohet gënjeshtar dhe jo këshillues për ummetin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Hadithi me kuptimin e kundërt jep të kuptohet se ai që transmeton ndonjë hadith duke mos e ditur se është gënjeshtër, nuk konsiderohet gënjeshtar. Mirëpo a konsiderohet mëkatar? Këtu dijetar Es-Sindij thotë se ky person është mëkatar për shkak të ngutjes dhe ekspozimit të tij në transmetimin e haditheve të të Dërguarit duke mos qenë i sigurt në saktësinë e tyre dhe për këtë e meriton ta konsiderojmë mëkatar. Allahu e di më së miri.

Për këtë arsye, dijetari El-Munavij thotë se shumë prej tabi'inëve frikësoheshin që hadithet t'i ngrinin deri tek i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, por i transmetonin nga sahabët duke konsideruar se nëse hadithi ishte gënjeshtër dhe jo i vërtetë nga i Dërguari, atëherë gënjeshtër ndaj sahabit ishte më e lehtë sesa ndaj të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

*Mr. Fidan XHELILI  
Amman/Jordani*



# TË NJOHIM TË DËRGUARIN E ALLAHUT MUHAMEDIN

SAL - LALLAHU ALEJHI VE SEL - LEM

## MATERIAL NË FORMË PYETJE – PËRGJIGJE (PJESA E PARË)

*Transmetohet nga Ebi Katadeh radijAllahu anhu se “I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem u pyet në lidhje me agjërimin e ditës së hënë dhe tha: “Në këtë ditë kam lindur unë.”*

### **1 Kur ka lindur i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem?**

Ai sal-lallahu alejhi ve sel-lem lindi ditën e hënë, më 12 të muajit Rabi'u el Euel në Mekë. Transmetohet nga Ebi Katadeh radijAllahu anhu se “I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem u pyet në lidhje me agjërimin e ditës së hënë dhe tha: “Në këtë ditë kam lindur unë.” [1]

Dijetari i islamit, Ibnul Kajjimi (Allahu e mëshiroftë), ka thënë: “Nuk ka kundërshtim se ai sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka

lindur në Mekë dhe se lindja e tij ka qenë në vitin e “Elefantit – El Fil”.

### **2 Cila është prejardhja e tij sal-lallahu alejhi ve sel-lem?**

Ai (paqja dhe bekimi i Allahu qofshin mbi të) pa diskutim është prej familjes më të mirë në tokë. Ai është Muhamed ibën Abdullah ibën Abdulmutalib ibën Hisham ibën Abdumenaf ibën Kusaj ibën Kilab ibën Marrah ibën Kab ibën Lua ibën Galib ibën Fahër ibën Malik ibën

[1] Transmeton Muslimi.

En Nedar ibën Kenaneh ibën  
Huzejmeh ibën Mudriket  
ibën Iljas ibën Mudar  
ibën Nazar ibën  
Mead ibën  
Adnan.[2]

**3** Si e quajnë  
babain e  
Profetit sal-  
lAllahu alejhi  
ve sel-lem dhe  
kur ka vdekur?  
Emri i tij është  
Abdullah ibën Ab-  
dulmutalibi. Dijetari  
i Islamit, Ibnul Kajjimi  
(Allahu e mëshiroftë), ka  
thënë: “Ai vdiq, ndërsa i Dërguari i  
Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem nuk  
kishte lindur akoma.”

**4** Cilët janë disa prej emrave të të Dër-  
guarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve  
sel-lem dhe kush është më i njohuri prej  
tyre?  
Transmetohet nga Ebi Seid el Hudri radi-  
jAllahu anhu se ka thënë: “I Dërguari i  
Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka  
thënë: “Unë kam disa emra: unë jam  
Muhamedi, unë jam Ahmedi, unë jam El  
Mahiu me të cilin Allahu do të shfarosë  
kufrin, unë jam El Hashir,[3] nën këmbët e

të cilit do të tubohen njerëzit  
dhe unë jam El Akib.”[4]

[5]

Më i njohuri prej  
emrave të tij  
sal-lAllahu ale-  
jhi ve sel-lem  
janë  
Muhamed  
dhe Ahmed.  
Ibën Haxher  
(Allahu e  
mëshiroftë)  
ka thënë: “Më i  
njohuri nga këta  
të dy (Muhamed  
dhe Ahmed) është  
emri Muhamed, i cili për-  
mendet shumë herë në Kur’an.”

**5** Sa herë është përmendur i Dërguari i  
Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem  
me emrin e tij Muhamed në Kur’an?

Është përmendur katër herë:

(1) Allahu i Madhëruar thotë:

*“Muhamedi nuk është tjetër, veçse i Dër-  
guar, para të cilit kanë ardhur të gjithë të  
Dërguarit e tjerë.”*[6] [7]

(2) Allahu i Madhëruar thotë:

*“Muhamedi nuk është babai i askujt prej  
burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut  
dhe vula e Profetëve; Allahu është i  
Gjithëdijsëm për çdo gjë.”*[8]

[2] Ibën Hisham: vell. I.

[3] Për sa i përket El-Hashir, “hashr” do të thotë mbledhje dhe grumbullim. Është emërtuar kështu sepse njerëzit mblidhen përpara tij. Është njësoj si të jetë dërguar për të tubuar dhe grumbulluar njerëzit.

[4] El-Akib: Është quajtur kështu sepse është ai që erdhi pas gjithë Profetëve dhe pas tij s’ka më Profet. Pra, ai është i fundit.

[5] Mutefekun alejhi.

[6] Muhamedi është njëri prej të Dërguarve të Allahut, prej vargut të tyre dhe vula e tyre, pas të cilit nuk ka më të Dërguar tjetër, por vetëm dijetarë që u mësojnë njerëzve fenë e Allahut. Ashtu si edhe të gjithë të Dërguarit para Muhamedit, të cilët janë robër të Allahut dhe krijesa të Tij, edhe Muhamedi do të vdesë në afatin e përcaktuar nga Allahu, prandaj ju, o shokët e Muhamedit, nuk keni pse të llahtariseni e të brengoseni nëse atij i vjen vdekja. Këtu u tërhiqet vërejtja atyre besimtarëve që morën pjesë në luftën e Uhudit dhe kur dëgjuan se Muhamedi u vra, i kthyen shpinën armikut dhe e lanë luftën.

[7] Alu Imran: 144

[8] El Ahzab: 40

(3) Allahu i Madhëruar thotë: *“Ndërsa atyre që besojnë, kryejnë vepra të mira dhe besojnë në atë që i është shpallur Muhamedit...”*<sup>[9]</sup>

(4) Allahu i Madhëruar thotë: *“Muhamedi i Dërguari i Allahut...”*<sup>[10]</sup>  
Ndërsa për sa i përket emrit Ahmed, ai përmendet vetëm një herë në Kur'an. Allahu i Madhëruar thotë: *“Kujto kur Isai, i biri i Merjemes, tha: “O bijtë e Izraelit, unë jam i Dërguari i Allahut tek ju, për t’ju vërtetuar Teuratin e shpallur para meje dhe për t’ju sjellë lajmin e gëzueshëm për një të Dërguar, emri i të cilit është Ahmed, që do të vijë pas meje.” Por, kur ai u solli atyre shenja të qarta, ata thanë: “Kjo është magji e hapur!”*<sup>[11]</sup>

**6** Cilët janë xhaxhallarët e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem që e arritën Islamin? Kush prej tyre e pranoi fenë islame?

Ata janë katër: Ebu Lehebi, Ebu Mutalibi, emri i tij është Abdumenaf, Hamza dhe Abasi. Prej tyre fenë islame e pranuan Hamza dhe Abasi.

**7** Kush kanë qenë gjidhënëset e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem?

Theuijbeh, robëresha e Ebu Lehebit, dhe Halimeh. Te kjo e fundit i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem qëndroi katër vjet.

**8** Çfarë i ndodhi të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kur

ishite tek Halimeja?

Njëherë, kur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishte duke luajtur me dy djelmosha, i shkoi atij engjëlli Xhibril dhe ia hapi gjoksin, i nxorri zemrën dhe prej saj hoqi një copë dhe tha: “Kjo është pjesa e shejtanit.” Pastaj e lau zemrën me ujë zemzemi dhe e vendosi në vendin e saj.<sup>[12]</sup> Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë: *“Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhamed) krahatorin (për të pranuar besimin) dhe ta hoqëm barrën, e cila ta rëndonte tepër kurrizin dhe ta ngritëm lart emrin?! Me të vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi! Me të vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi! Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkush-tohu!”*<sup>[13]</sup>

**9** Si e ka pasur emrin e ëma e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem? Sa vjeç ka qenë ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kur ajo vdiq?

Atë e quanin Amineh ibën Uehb. Dije-tari i Islamit, Ibnul Kajjimi (Allahu e mëshiroftë), ka thënë: “Nuk ka kundër-shtim se nëna e tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka vdekur ndërmjet Mekës dhe Medinës.” Ndërsa Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka qenë gjashtë vjeç në kohën që i vdiq e ëma.

**10** Kush e mori nën kujdes atë sal-lAllahu alejhi ve sel-lem pas vdekjes së nënës së tij?

Atë e mori nën kujdes gjyshi i tij, Abdul-

[9] Muhamed: 2

[10] El Fer'h 29

[11] Es Saff: 6

[12] Për më shumë shih hadithin që e transmeton Enesi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij). Hadithi gjendet tek Muslimi.

[13] El-Inshirah: 1-8

mutalibi.

**11** Sa vjeç ishte Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kur vdiq gjyshi i tij, Abdulmutalibi? Kush u kujdes për të më pas?

Dijetari i Islamit, Ibnul Kajjimi (Allahu e mëshiroftë), thotë: “Atë e mori në përku-jdesje gjyshi i tij Abdulmutalibi. I Dër-guari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka qenë tetë vjeç kur vdiq gjyshi i tij, Abdulmutalibi. Pastaj e mori nën ku-jdes xhaxhai i tij, Ebu Talibi.”

**12** Çfarë i ndodhi Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kur ishte në moshën dymbëdhjetëvjeçare?

Xhaxhai i tij do të shkonte për tregti në Sham. Me këtë rast mori me vete edhe Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Kur arritën afër Basras, ata u takuan me një murg, i cili quhej Behira. Ai u afrua dhe e kapi për dore Profetin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe tha: “Ky është zotëria e njerëzimit, të cilin Allahu e ka dërguar si mëshirë për mbarë njerëz-imin.” Njerëzit më të vjetër prej kure-jshëve i thanë atij (murgut): “Ku e di ti këtë gjë?” Ai tha: “Kur ju dolët prej Ak-abes, nuk mbeti pemë dhe as gurë pa rënë në sexhde. E ato nuk i bien në sex-hde vetëm se për Profetin.” [14]

**13** Çfarë punësh ka bërë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem para profetësisë?

Ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka qenë

bari delesh.[15]

**14** Kush është gruaja e parë me të cilin është martuar Profeti sal-lAl-lahu alejhi ve sel-lem?

Gruaja e parë më të cilën është martuar Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është Hatixhe bintu Huvejlid. Dijetari i Is-lamit, Ibnul Kajjim (Allahu e mëshi-roftë), ka thënë: “Ajo, Hatixhja, është e para grua me të cilën është martuar.”

**15** Sa vjeç ishte Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kur u martua me Hatixhen?

Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka qenë 25 vjeç kur u martua me Hatixhen. Kjo është fjala e xhumhurve (shumicës së dijetarëve).

**16** Pse Hatixhja ka qenë gruaja me e dashur për të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem?

- Ajo ishte e para e cila besoi tek ai.  
- E ndihmoi kur të tjerët e lanë.  
- Të gjithë fëmijët i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i kishte me Hatixhen, përveç Ibrahimit, të cilin e lindi Maria.

**17** Kush janë fëmijët e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem?

Meshkujt:

*Kasimi* - ishte djali i madh i të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

[14] Shih hadithin që transmeton Et Tirmidhiu.

[15] Shih hadithin që transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) dhe ndodhet te Buhariu.

Kasimi jetoi deri në moshën dyvjeçare.

Abdullahu- ka vdekur i vogël dhe ka qenë i fundit prej fëmijëve që i kanë lindur me Hatixhen.

*Ibrahimi* - ka lindur në Medinë nga robëresha e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, Marie el Kutbijeh.

Vajzat:

*Zejnebja* - ishte vajza e madhe e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Ajo u martua me Ebu el As ibën Rabian, ku fryt i kësaj martese ishin dy fëmijë; një djalë, Aliu, dhe një vajzë, Uameh. Zejnebja ka vdekur në Medinë në fillim të vitit 8 hixhri.

*Rukija* - u martua me Uthman ibën Affanin (Allahu qoftë i kënaqur prej tij). Ajo lindi një djalë që quhej Abdullah, i cili jetoi deri në moshën gjashtëvjeçare. Rukija vdiq në kohën kur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishte në luftën e Bedrit.

*Ummu Kulthumi* - I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem pas vdekjes së Rukijes e martoi Ummu Kulthumin me Uthman ibën Affanin (Allahu qoftë i kënaqur prej tij). Uthmani nuk pati asnjë fëmijë me Ummu Kulthumin. Ajo vdiq


në vitin e 8-të hixhri dhe është varrosur në Bekia.

*Fatimja* - ishte më e vogla prej vajzave të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe më e dashura për të. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë në lidhje me Fatimen se ajo është zonja e grave të xhenetit. I

Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e martoi atë me Ali ibën Ebi Talibin (Allahu qoftë i kënaqur prej tij). Nga kjo martesë lindën dy djem, të cilët Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i donte shumë- ata janë Hasani dhe Huseni si dhe dy vajza, Zejnebja dhe Ummu Kulthumi.

Vijon...

*Përgatiti dhe përshtati: Xhabir SHEME  
Lushnje/Shqipëri*





# A KA MË TË DREJTË SE MUHAMEDI

SAL - LALLAHU ALEJHI VE SEL - LEM

*Ai e lajmëroi se një njeri tha atë që tha, por në atë moment fytyra e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ndryshoi derisa u skuq e më pas tha: “E kush do të ndajë drejtësi nëse Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk ndajnë drejtësi?”*

**T**42. Transmetohet nga Ibën Mes’udi radijAllahu anhu, i cili ka thënë: “Pas betejës së Hunejnit, i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i dalloj disa njerëz në ndarje (të plaçkës së luftës). I dha El-Akra ibën Habisit njëqind deve, i dha edhe Ujejne ibën Hisnit. U dha disa njerëzve me autoritet nga arabët duke i dalluar atë ditë në ndarje. Një njeri tha: “Për Allahun, kjo ndarje nuk u bë me drejtësi dhe me këtë nuk ishte për qëllim kënaqësia e Allahut.” Unë thashë: “Për Allahun, do ta lajmëroj për këtë të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Shkova deri tek ai dhe e lajmërova për atë që kishte thënë. Në moment fytyra e tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ndryshoi, derisa u bë e tëra si e skuqur dhe më pas tha: “E kush do të ndajë drejtësi nëse Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk ndajnë drejtësi?” Pastaj tha: “Allahu e mëshiroftë Musain, është ofenduar edhe me më shumë se kjo, por bëri durim.” Thashë: “Vërtet nuk do t’i tregoj pas kësaj asnjë ndodhi.”<sup>[1]</sup> Fjala kes-sirfi është ngjyrë e kuqe e përzier me blu. Sqarimi

Në këtë hadith të përmendur nga autori, Allahu e

mëshiroftë, Abdullah ibën Mes’udi radijAllahu anhu tregon se ishte beteja e Hunejnit, që ndryshe quhet beteja e Taifit, e cila ndodhi pas çlirimit të Mekës. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem luftoi dhe fitoi shumë pasuri- deve, dele, dërrhemë dhe dinarë. Më pas i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u ndal në Xhiarr-rrane, një vend në përfundim të haremit (të Mekës), në anën e Taifit. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, pasi u ndal në këtë vend, filloi të ndajë plaçkën e luftës. Ndau për disa nga luftëtarët për t’i përfutur zemrat e tyre, d.m.th. që ishin nga fiset e mëdha, duke i tërhequr në Islam dhe kështu u dha shumë nga plaçka e luftës, saqë vetëm njërit prej tyre i dha njëqind deve.

Një nga të pranishmit tha: “Për Allahun, kjo ndarje nuk u bë me drejtësi dhe me këtë nuk ishte për qëllim kënaqësia e Allahut.” Allahu na ruajtë! Si mund të thuhet kjo fjalë për ndarjen që kishte bërë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem? Dashuria ndaj kësaj bote dhe nxitja e shejtanit e çojnë njeriun drejt shkatërrimit. E lusim Allahun të

[1] Mutefekun alejh

na falë! Kjo fjalë është fjalë kufri sepse i atribuon Allahut dhe të Dërguarit të Tij padrejtësi dhe se Profeti sal-IAllahu alejhi ve sel-lem me këtë ndarje nuk kishte për qëllim kënaqësinë e Allahut. Por s'ka dyshim se Profeti me këtë ndarje dëshiroi kënaqësinë e Allahut, dëshiroi që t'i përfitojë zemrat e të parëve të fiseve në mënyrë që t'i përforcojë në Islam, se nëse të parët e popullit përfitohej dhe u forcohet imani, me këtë vijnë mirësi të shumta sepse ata pasohen nga fiset e tjera dhe kështu forcohet Islami. Por injoranca, Allahu na ruajtë, e shkatërron njeriun.

Kur Abdullah ibën Mes'udi dëgjoi këtë fjalë për të Dërguarin e Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, e lajmëroi për këtë Profetin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Ai e lajmëroi se një njeri tha atë që tha, por në atë moment fytyra e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ndryshoi derisa u skuq e më pas tha: *"E kush do të ndajë drejtësi nëse Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk ndajnë drejtësi?"* Të vërtetën thotë Profeti i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem! Nëse ndarja e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij nuk ka drejtësi, kush do të ndajë drejtësi atëherë?! Pastaj tha: *"Allahu e mëshiroftë Musain, është ofenduar edhe me më shumë se kjo, por bëri durim."* Ajo që na nevojitet nga ky hadith është fjala e fundit, e cila tregon se Profetët alejhimus-salatu ves-selam fyheshin, por bënë durim. Profetit tonë sal-IAllahu alejhi ve sel-lem iu tha kjo fjalë tetë vite pas hixhretit, domethënë jo në fillim të misionit të tij, por pasi Allahu ia mundësoi triumfin, pasi ishte bërë i njohur sinqeriteti i tij, pasi Allahu i nxori në shesh shenjat e profetësisë në këtë gjithësi dhe në personalitetin e tij. Megjithatë, prapë iu tha se ndarja nuk u bë me drejtësi dhe me të nuk ishte për qëllim kënaqësia e Allahut. Kur kjo fjalë u tha nga një shok i Profetit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, atëherë mos u çudit nëse dikush thotë për ndonjë dijetar "ky dijetar është kështu e ai dijetar është ashtu" apo i atribuojnë të meta, pasi shejtani i nxit dhe i përkrah që të shpifin për dijetarët. Kur ata shpifin për dijetarët, atëherë fjalët e dijetarëve nuk pranohen nga njerëzit dhe kështu nuk mbetet askush që t'i udhëheqë njerëzit me librin e Allahut. Kush do t'i udhëheqë ata me librin e Allahut nëse ata nuk u besojnë dijetarëve dhe fjalëve të tyre? Ata atëherë do t'i udhëheqë shejtani dhe partia e tij. Për këtë arsye, përgojimi i dijetarëve është mëkat shumë më i rëndë se përgojimi i të tjerëve. Përgojimi i të tjerëve është përgojim personal dhe nëse dëmtohet dikush, dëmtohet vetëm ai që është përgojuar, ndërsa përgojimi i dijetarëve i bën dëm gjithë Islamit sepse dijetarët mbajnë lart flamurin e Islamit.

Nëse bie besueshmëria në fjalët e tyre, do të fundoset flamuri i Islamit dhe ky dëm do të përfshijë gjithë ummetin e muslimanëve. Nëse përgojimi i njerëzve është si ngrënia e mishit të të vdekurit, atëherë përgojimi i dijetarëve është si ngrënia e mishit të të vdekurit duke qenë i helmuar, për arsye se në të ka dëm të madh. Atëherë mos u çudit nëse dëgjon dikë duke fyer dijetarët. Kur të Dërguarit të Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i është thënë ajo që i është thënë, atëherë bëj durim dhe shpresë shpërblimin tek Allahu az-ze ve xhel-le dhe dije se përfundimi është në të mirë të atyre që kanë frikë Allahun. Përderisa njeriu e ka frikë Allahun, përfill urdhrat e Tij dhe është në dritën e udhëzimit të Tij, pa dyshim që përfundimi do të jetë në të mirën e tij. Ka njerëz që kur ndonjë shok apo i afërt gabon vetëm një herë, e cilësojnë se ka të meta dhe e fyejnë. Allahu na ruajtë nga ky gabim! Kush është cilësuar se ka ndonjë të metë, le të bëjë durim, le ta dijë se Profetët e Allahut janë fyer, janë keqtrajtuar dhe përgënjeshtuar, saqë u është thënë se janë të çmendur, poetë, fallxhorë, magjistarë etj. *"Por ata ishin të durueshëm ndaj gënjeshtërave dhe torturave përderisa u erdhi ndihma Jonë."*<sup>[2]</sup> Kështu thotë Allahu az-ze ve xhel-le. Ky hadith na argumenton se prijësi i muslimanëve ka të drejtë t'i japë atij që sheh se ka përfitim për Islamin, qoftë edhe nëse i jepet më shumë se të tjerëve, por jo nëse ka përfitim personal. Nëse sheh se prej saj ka leverdi Islami, i jep më shumë dhe kjo është e drejtë e tij dhe ai është përgjegjës për këtë para Allahut. Nuk lejohet për askënd ta kundërshtojë atë në këtë sepse kush kundërshton, vetëm se i ka bërë padrejtësi vetes. Ky hadith gjithashtu na tregon se Profeti sal-IAllahu alejhi ve sel-lem merrte mësim nga ata të Dërguar që ishin para tij dhe për këtë tha: *"Musai është ofenduar edhe me më shumë se kjo, por bëri durim"*, sepse Allahu i Lartësuar thotë: *"Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti (o Muhamed) ndiq rrugën e tyre."*<sup>[3]</sup> Pra, Allahu e urdhëroi Profetin e Tij sal-IAllahu alejhi ve sel-lem që të ndjekë rrugën e Profetëve para tij. Edhe ne duhet t'i pasojmë Profetët alejhimus-salatu ves-selam në durimin ndaj sprovave dhe të shpresojmë shpërblimin tek Allahu, duke e ditur se kjo është ngritje e gradave tona me shpërblim dhe falje nga gjynahet. Vetëm prej Allahut është suksesi!

*Komenti i librit Rijadus Salihin nga Muhamed ibën Salih el Uthejmin.  
Përshtati: Sabahudin SELIMI  
Viti/Kosovë*

[2] El-Enam, 34.

[3] El-Enam, 90.



# MESATARJA E EHLI SUNNETIT NË LAVDËRIMIN E PROFETIT

SAL-LALLAHU ALEJHI VE SEL-LEM

*Ehli Sunneti i bashkojnë Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem gradën e të qenët krijesë dhe rob i Allahut dhe misionin profetik. Kjo është grada më e përsosur, ashtu siç i bashkoi Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në një fjalë të tij kur tha: “Kush dëshmon se nuk ka të adhuruar me të drejtë pos Allahut, që është i vetëm e pa shokë, dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij...”*

Në këtë punim do të paraqesim një pjesë të bindjes së Ehli Sunnetit dhe fjalët e tyre për këtë kapitull dhe më pas do të sqarojmë qëndrimin e atyre që e tepruan dhe neglizhuan në këtë çështje, sipas pikave në vijim.

*Së pari: Qëndrimi i Ehli Sunnetit për këtë kapitull*

Ehli Sunneti në Islam është sikurse ky ummet në mesin e umeteve të tjera. Ashtu si ummeti i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është më i miri dhe i mesmi në raport me ummetet e tjera, ashtu është edhe Ehli Sunneti në krahasim me grupimet e tjera, të cilët konsiderohen muslimane. Kjo iu mundësua Ehli Sunnetit duke pasur parasysh të kapurit e fortë

pas asaj që rekomandon dhe argumenton libri i Allahut dhe Sunneti i Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në të gjitha çështjet. Kjo e bëri Ehli Sunnetin që të jenë të qëndrueshëm në rrugën e drejtë dhe të mos devijojnë duke shkuar në ekstreme apo në të kundërtën e saj, pra të jenë neglizhentë, siç vepruan të tjerët nga grupimet e ndryshme.

Qëndrimi dhe besimi i tyre në të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është nga argumentet që na bënë të besojmë në saktësinë e kësaj që them. Në vijim do të sjellim një përmbledhje nga fjalët dhe qëndrimet e tyre në lavdërimin dhe respektin ndaj Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

1. *Besojnë se Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij* Ehli Sunneti i bashkajnë Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem gradën e të qenët krijesë dhe rob i Allahut dhe misionin profetik. Kjo është grada më e përsosur, ashtu siç i bashkoi Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në një fjalë të tij kur tha: “Kush dëshmon se nuk ka të adhuruar me të drejtë pos Allahut, që është i vetëm e pa shokë, dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij...”<sup>[1]</sup>

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem erdhi me këto dy cilësi të cilat i bashkoi si qartësim ndaj ekstremitetit dhe neglizhencës, sepse shumë prej atyre që pretendojnë se janë pasues të tij kanë shkuar në ekstrem me fjalët dhe veprat e tyre duke lënë anash pasimin e tij...<sup>[2]</sup> Imam Tahaviu, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij “Akideja e Ehli Sunnetit”, ka thënë: “...dhe vërtetë Muhamedi është rob dhe Profet i zgjedhur i Allahut, i Dërguari i Tij i dëshiruar.”<sup>[3]</sup>

I bashkohen Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem grada e robërisë ndaj Allahut dhe profetësisë e mesazhi i tij. Ehli Sunneti ia dëshmon këto.

2. *Dëshmojnë dhe besojnë se ai është më i miri nga të Dërguarit dhe zotëria i të gjitha krijesave*

Vetë Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Unë jam zotëria i bijve të Ademit dhe nuk ka lavdërim.”<sup>[4]</sup>

3. *E shohin dashurinë ndaj tij si obligim dhe*

*se kjo është pjesë e imanit dhe fesë*

Ata mbështeten në fjalët e Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “Nuk ka besuar askush përderisa nuk jam më i dashur tek ai se fëmija i tij, prindi i tij dhe të gjithë njerëzit.”<sup>[5]</sup>

“Tek ai që gjenden tri gjëra e ka shijuar ëm-bëlsinë e imanit: që Allahu dhe i Dërguari i Tij të jenë më të dashur tek ai se çdokush tjetër...”<sup>[6]</sup>

Ehli Sunneti e duan Profetin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe e lartësojnë atë. Shumë shembuj nga sahabët na bëjnë të kuptojmë se ata ishin në gjendje të flijonin veten për të Dërguarin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e donin atë më shumë se fëmijët, prindërit dhe veten e tyre, siç tregohet në ngjarjen e Umerit radijAllahu anhu.<sup>[7]</sup>

Ehli Sunneti shohin se kërkesat dhe shenjat e dashurisë ndaj tij janë praktikimi i gjithë asaj që ka urdhëruar, besimi me sinqeritet në atë që ka treguar dhe largimi nga ajo që ai ka ndaluar. Pasimi dhe respektimi i tij është shenja që argumenton dashurinë ndaj tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe njëherazi argumenton dashurinë ndaj Allahut subhanehu ve teala ashtu siç ka thënë Allahu i Lartësuar: “**Thua ju: (o Muhamed): Nëse ju e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.**”<sup>[8]</sup>

Imam ibën Kethiri, Allahu e mëshiroftë, në komentimin e këtij ajeti ka thënë: “Ky ajet është gjykues ndaj kujtdo që pretendon se

[1] “Kitabul-Iman” 1/57.

[2] Shiko “Fethul-Mexhid”, faqe 37, i Abdurrahman ibën Hasen Ali shejh.

[3] Shiko “Sherh et-Tahavije”, fq. 157.

[4] Transmeton Muslimi, fq. 1782.

[5] Transmeton Buhariu (15), Muslimi (44).

[6] Transmeton Buhariu (16), Muslimi (43).

[7] Është transmetuar në hadithin e Abdullah ibën Hishamit radijAllahu anhu, i cili thotë: “Ishim me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ndërsa ai kishte për dore Umer ibën Hattabin. Umeri i tha atij: “O i Dërguari i Allahut, ti je më i dashur për mua se çdo gjë tjetër përveç vetes sime. Atëherë Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: “Jo, për Atë që në dorën e Tij është shpirti im, përderisa nuk jam më i dashur për ty sesa vetja.” Umeri i tha: “Për Allahun, ti je më i dashur për mua se vetja ime.” Atëherë Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i tha: “Tani (u plotësua), o Umer.” Transmeton Buhariu, 6632.

[8] Alu Imran, 31

e do Allahun dhe nuk shkon sipas Traditës së Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ai është gënjeshtar në pretendimin e tij për këtë çështje derisa ta pasojë shariatën dhe fenë e Profetit në të gjitha fjalët, veprat dhe gjendjen e tij.”<sup>[9]</sup>

Kështu është çdokush që pretendon se e do të Dërguarin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe nuk e pason fenë dhe shariatën me të cilin është dërguar ai. Nëse nuk është praktikues i saj, ai është duke gënjyer në pretendimin se e do atë.

“Nëse një njeri do ta njohë realisht përqindjen e dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në zemrën e tij, atëherë le t’i krahasojë fjalët dhe veprat e tij me librin e Allahut dhe Sunnetin e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Nëse ato përputhen me atë që erdhi Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, atëherë ky është argument në sinqeritetin e dashurisë. Por nëse fjalët dhe veprat e tij nuk përputhen (me Kur’anin dhe Sunnetin), atëherë pretendimi i tij ndaj dashurisë (së Allahut dhe Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) nuk është i vërtetë...”<sup>[10]</sup>

Nga shenjat që tregojnë vërtetësinë e dashurisë ndaj Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është flijimi i tij për shariatën dhe për atë që solli Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke e kundërshtuar pasimin e mendjes dhe tekave të tij. Kadi Ijadi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Dije se ai që me të vërtetë do diçka, ajo lë gjurmë tek ai dhe është i pajtuar me të. Nëse jo, nuk mund të ketë qenë i sinqertë në dashurinë ndaj tij, por vetëm pretendues. I sinqertë në dashurinë për Profetin sal-lAllahu alejhi

ve sel-lem është ai tek i cili shihen qartë shenjat (e pasimit), duke nisur nga pasimi i tij dhe praktikimi i Sunnetit të tij, pasimi i fjalëve dhe veprave të tij, veprimi i urdhrave të tij, largimi nga ndalesat e tij dhe sjellja me sjelljet e tij në vështirësi dhe lehtësi, në qetësi dhe fatkeqësi. Argument për këtë janë fjalët e Allahut të Lartësuar: **“Thuaju: (o Muhamed) Nëse ju e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që Allahu t’ju dojë ju...”**<sup>[11]</sup>

4. Dëshmojnë dhe besojnë se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është vula e profetësisë

Kushdo që pretendon se është Profet pas tij, ka gabuar dhe ka pasuar mendjen e tij,<sup>[12]</sup> pasi nuk ka Profet pas Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ashtu siç na ka treguar Allahu i Madhëruar për vulosjen e profetësisë me ardhjen e tij. “Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e të gjithë Profetëve. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.”<sup>[13]</sup>

Kushdo që pretendon se është Profet pas tij është në gënjeshtëri dhe humbje.

5. Besojnë se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem nuk di asgjë nga dituria e fshehtë në jetën e tij, me përjashtim të asaj që Allahu i mësoi (përmes shpalljes). E, si mund të dijë pas vdekjes së tij?

Këtë e mbështetin në argumentet që kanë ardhur në këtë temë, si fjalët e Allahut të Lartësuar: **“Thuaj: (O Muhamed): “Unë nuk ju them se zotëroj thesaret e Allahut apo se e di të padukshëm, të fshehtë dhe as nuk them se jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më është shpallur mua...”**<sup>[14]</sup> Si dhe fjalët e Allahut: **“Thuaj: “Unë nuk mund t’i sjellë vetes**

[9] “Tefsir el-Kur’anil-Adhim” 2/25.

[10] Abdul-Muhsin el-Abbad, njëzet hadithe nga “Sahihu” i Buhariut, fq. 166.

[11] Alu Imran: 31

[12] “Et-Tahavijje”, fq. 176.

[13] El-Ahzab: 40

[14] El-En’am: 50.

*as dobi as dëm, përveç asaj që dëshiron Allahu. Sikur ta dija të fshehtë, do t'i shumoja të mirat dhe nuk do të më prekte asnjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëm se qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë.*"<sup>[15]</sup>

S'ka dyshim se të fshehtë e di vetëm Allahu i Lartësuar. *"Çelësat e fshehtësive janë vetëm tek Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të njomë dhe s'ka të thatë që nuk është (shënuar) në librin e qartë (Levhi - Mahfudh)."*<sup>[16]</sup>

Ndërsa robërit e Tij, krijesat e Tij nga engjëjt, xhinët dhe njerëzit, duke përfshirë Profetët dhe të Dërguarit e Tij, dinë nga dituria e fshehtë atë që Allahu u mësoi (përmes shpalljes për Profetët), siç ka thënë Allahu i Lartësuar: *"Ai është që e di të fshehtë, por fshehtësinë e Vet nuk ia zbulon askujt. Me përjashtim të ndonjë të Dërguari që Ai do. Para dhe pas tyre Ai vë mbikëqyrës (engjëj kur i zbret shpalljen)."*<sup>[17]</sup>

*Allahu nuk ia zbulon diturinë e fshehtë askujt, përveç ndonjë të zgjedhuri nga të Dërguarit e Tij. I zbulon nga dituria e fshehtë aq sa dëshiron për të argumentuar për profetësinë e tij me një shenjë, një mrekulli që tregon për të fshehtë.*"<sup>[18]</sup>

Ky zbulim i së fshehtës nga ana e Allahut për të Dërguarit e Tij ishte vetëm gjatë jetës së tyre dhe vetëm ajo që Allahu i Lartësuar dëshironte t'u shfaqte, ndërsa pas vdekjes u është ndërprerë shpallja dhe janë shpërngulur te Zoti i tyre.

Me këtë qartësohen ata të humbur të cilët

pretendojnë se Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e di të fshehtë pas vdekjes së tij.


6. *Ehli Sunneti i ndalojnë vetes dhe të tjerëve që t'i kalojnë kufijtë në lavdërimin e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*

Kjo vjen si rezultat i parandalimit që Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i bëri ummetit të tij për moskalimin e kufirit në lavdërimin e tij me lavdërime të kota. Kjo çon drejt ngritjes së pozitës së tij më shumë sesa i dha Allahu. Ajo është pozita e të qenurit rob dhe i dërguar me revelat nga Allahu, pas së cilës

mbetet vetëm pozita e uluhijes dhe rububijes, të cilat i takojnë vetëm Allahut. Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ka urryer që ummeti i tij të bjerë në këtë gabim dhe e ndaloi që të kalohen kufijtë në ngritjen e pozitës dhe vendit të tij (më shumë seç e ngriti Allahu). I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Mos më lartësoni mua ashtu si të krishterët lartësuan birin e Merjemes sepse vërtet unë jam rob i Allahut. Atëherë thoni rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij."*<sup>[19]</sup> Kjo do të thotë mos më

lavdëroni dhe t'i kaloni kufijtë në lavdërimin ndaj meje ashtu siç i kaluan të krishterët në lavdërimin e Isait, duke e ngritur atë në pozitën e rububijes (në pozitën e Krijuesit), sepse vërtet unë jam rob i Allahut. Më cilësoni me këtë ashtu siç më cilësoi Zoti im. Pra thoni rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij.

Ndërsa adhuresit e varreve e mohuan këtë



[15] El-A'raf: 188.

[16] El-En'am: 59.

[17] El-Xhinn: 26-27.

[18] "Mealimut-Tenzil lil-Begavij", 4/406.

[19] Transmeton Buhariu, 3445.

dhe e kundërshtuan urdhrin e tij, u zhyten në këtë ndalesë dhe e shfuqizuan me shfuqizimin më të madh. Ata menduan se nëse e cilësojnë me fjalët rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij, nëse nuk luten dhe nuk kërkojnë ndihmë prej tij, nëse nuk therin kurban për të..., kjo e ul pozitën dhe vlerën e tij. Ata e ngritën mbi pozitën e tij, kërkuan nga ai falje mëkatesh, shpëtim nga vuajtjet dhe ankthet.<sup>[20]</sup> Ky është përngjasim me të krishterët, por ne u ndaluam nga një gjë e tillë.

*7. Besojnë dhe e shohin obligim dërgimin e salavateve dhe selameve për të*

Duke iu përgjigjur urdhrin e Allahut për besimtarët në fjalët e Tij: ***"Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për të. O besimtarë, lutuni për të dhe përshëndeteni (dërgoni salavate dhe selame) me selam!"***<sup>[21]</sup>

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem na e mësoi formën e përshëndetjes kur u pyet nga disa sahabë: *"Allahu i Lartësuar na urdhëroi që të dërgojmë salavate mbi ty, por si ta bëjmë këtë?"* Ai tha: *"Thoni: O Allahu im, mëshiroje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç e mëshirove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Me të vërtetë Ti je Falënderues dhe i Lavdishëm. O Allah, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu si e bekoje Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, me të vërtetë Ti je Falënderues dhe i Lavdishëm."*<sup>[22]</sup>

Kush shpik ndonjë formë tjetër përveç kësaj, ai nuk është pasues i Sunnetit, ashtu siç është gjendja e shumë pasuesve të bidatit dhe sufive.

*8. Besojnë dhe dëshmojnë se Muhamedi sal-*

*lAllahu alejhi ve sel-lem e ka treguar të gjithë atë që u urdhërua nga Zoti i Tij dhe nuk ka fshehur asgjë*

Ebu Muhamed ibën Hazmi ka thënë:

*"...Dijeni se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem nuk ka fshehur nga sheriatit qoftë edhe një fjalë apo më shumë..."*<sup>[23]</sup>

Kadi Ijadi ka thënë: *"Nuk ka mospajtim (mes dijetarëve) se Profetët janë të mbrojtur nga fshehja e shpalljes dhe mangësia në tregim, sqarim..."*<sup>[24]</sup>

Si është e mundur të mendohet se Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka fshehur diçka nga shpallja që i ka zbritur, kur dihet se Zoti i tij e urdhëroi që t'ua tregojë atë robërve të Tij. Allahu i Lartësuar thotë: ***"O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt!"***<sup>[25]</sup>

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem nuk e kundërshton urdhrin e Zotit të tij dhe as nuk e mendon një gjë të tillë. Ai nuk shpif në shpalljen e Zotit të Tij. Kush thotë se Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem nuk ka treguar nga shpallja asgjë apo ka mënjeluar diçka prej saj duke mos e treguar apo i ka veçuar disa nga ummeti i tij me të, vetëm se ka pohuar rrejshëm dhe ka shpifur për të Dërguarin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem një fjalë të urryer.

Vijon

*Shkëputur nga libri "Vasatij-jetu Ehli-Sun-neh bejnel-firak"*

*Autor: Dr. Muhammed ba Kerim Muhammed ba AbdAll-llah*

*Përshtati në shqip: Sabahudin SELIMI  
Viti/Kosovë*

[20] "Tejsirul-Azizul-Hamid, fq. 315, Sulejman ibën Abdullah ibën Muhamed ibën Abdul-Vehhab.

[21] El-Ahzab: 56.

[22] Transmeton Buhariu, 3370.

[23] "El-Faslu fil-Mileli ven-Nihal", 2/116.

[24] "Esh-Shifa", 2/144.

[25] El-Maide: 67.

# FRAGMENTE NGA EDUKATA E SAHABËVE ME PEJGAMBERIN KËSHILLA DHE MËSIME EDUKATIVE PËR NE

*Nga brenga e madhe Ebu Ejjubi me familje nuk fjetën atë natë me qëllim që mos të lëviznin sa ishin në gjumë dhe nga lëvizja të binte pluhur mbi Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ta dëmtonte atë.*

Falënderimet dhe lavdërimet qofshin për Allahun Fuqiplotë, kurse salavatet dhe selamet më të mira qofshin për të Dërguarin e Allahut, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, familjen e tij, shokët e tij si dhe për të gjithë ata që e pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Allahu thotë:

*"Me të vërtetë, Ne të kemi dërguar ty (Muhamed) dëshmitar, përgëzues dhe qortues. Që ti besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që ta ndihmoni e ta nderoni atë (Muhamedin) dhe që ta lavdëroni Atë (Allahun) me namaz në mëngjes dhe mbrëmje."* [1]

*"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare.*

*Vërtet, ata që ulin zërin në pranë të të Dërguarit të*

*Allahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh. Vërtet, ata që të thërrasin ty (o Muhamed) me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh."* [2]

Shumë ajete të tjera në Kur'anin Famëlartë na urdhërojnë rreptësisht ta nderojmë Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe të sillemi me edukatë të lartë ndaj tij. Sahabët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem gjatë jetës së tyre ishin të vetmit që i praktikuan me përpikmëri këto ajete dhe të tjera, saqë nuk njihet në historinë e njerëzimit tjetër gjeneratë që i madhëroi dhe i nderoi të drejtat e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem si ata. Ja disa ngjarje që e tregojnë këtë edukatë të lartë të sahabëve me Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.[3]

[1] El-Fer'h:8-9

[2] El-Huxhurat: 2-4

[3] Buhariu: 684,1218,1234 dhe Muslimi: 976.

NGJARJA E PARË: Të gjithë e dimë rastin kur Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem e urdhëroi Ebu Bekrin radijAllahu anhu të dilte imam për t'ua falur muslimanëve namazin, kur ai ishte i sëmurë pak para vdekjes. Kur Ebu Bekri vërejti se Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem kishte ardhur dhe qëndronte pas tij, Ebu Bekri kthehet pas në saf dhe ia lëshon vendin Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Pas përfundimit të namazit, Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i thotë: *"O Ebu Bekër, ç'të pengoi të qëndrosh në vendin tënd pasi të urdhërova për një gjë të tillë?" Ebu Bekri iu përgjigj: "Nuk i përket të birit të Ebu Kuhafes (pseudonimi i babait të Ebu Bekrit) të dalë imam në prezencën e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem."*

NGJARJA E DYTË: Në Marrëveshjen e Hudejbijes, Urvetu ibën Mes'udi i vështroi shokët e Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe tha: "Vallahi, pështynte Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe pështyma e tij binte në duart e shokëve të tij, të cilët (nga dashuria e madhe ndaj Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem) fërkonin me pështymën e tij fytyrat dhe trupat e tyre. Urdhëronte Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem diçka dhe shokët e tij garonin kush po ta zbatonte i pari, kurse kur merrte (Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem) abdest, sa nuk vrisnin njëri-tjetrin se kush ta shfrytëzonte i pari ujin e mbetur nga abdesti i tij. Kur fliste i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, uleshin zërat, saqë nga turpi i madh që kishin ndaj tij nuk kishin guxim ta shikonin në fytyrë." Pastaj Urveja u kthye në drejtim të shokëve të tij dhe tha: "O popull! Vallahi kam vizituar shumë mbretër... por nuk kam parë mbret që e nderonin shokët e tij siç e nderonin sahabët Muhamedin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem (edhe pse ai nuk ishte mbret)."<sup>[4]</sup>

Në të njëjtën ngjarje tregohet se Urvetu ibën Mes'udi pastaj kishte hyrë tek Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem për t'i folur diçka, kurse Mugiretu ibën Shu'beh qëndronte mbi kokën e

Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem me shpatë (si roje e tij). Në ato çaste, një nga njerëzit i fliste Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe duke folur lëvizte gishtin tregues, i cili pa dashje preku mjekrën e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Në moment reagoi Mugireh radijAllahu anhu dhe i tha atij njeriu: "Ule dorën para se ta gësh atë të prerë para vetes."<sup>[5]</sup>

NGJARJA E TRETË: Është pyetur Abbasi radijAllahu anhu, xhaxhai i Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, se kush ishte më i madh, ai apo Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem? Abbasi radijAllahu anhu tha: "Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem është më i madh se unë, kurse unë kam lindur para tij."<sup>[6]</sup>

NGJARJA E KATËRT: Kur u shpërngul Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në Medinë, u vendos në shtëpinë e Ebu Ejjub Ensariut radijAllahu anhu. Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem u vendos në katin e parë, kurse Ebu Ejjubi me bashkëshorten e tij në katin e dytë. Gjatë natës Ebu Ejjubit radijAllahu i kujtohet ky gabim dhe i thotë gruas së tij: "Si është e mundur të gabojmë në këtë mënyrë, duke e lënë Pejgamberin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem nën ne? Shpallja i zbret atij dhe ne të qëndrojmë mbi shpallje?"

Nga brenga e madhe Ebu Ejjubi me familje nuk fjetën atë natë me qëllim që mos të lëviznin sa ishin në gjumë dhe nga lëvizja të binte pluhur mbi Pejgamberin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem e ta dëmtonte atë.

Kur agoi, shkoi Ebu Ejjubi tek Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe i thotë: "O i Dërguari i Allahut! Nuk fjetëm fare mbrëmë as unë e as Ummu Ejjubi." Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Përse o Ebu Ejjub?"* I tha: "U kujtova se unë qëndroj mbi ty, kurse ti nën ne dhe e urreva të qëndrosh nën ne me qëllim që mos të të dëmtojmë dhe të shqetësojmë për shkak të lëvizjeve tona."<sup>[7]</sup>

[4] Buhariu 5/330

[5] Buhariu 5/330

[6] E transmeton Taberiu ashtu siç thotë Hejthemiu në "Mexhmeuz-zevid" dhe senedi i tij është sahih.

[7] Transmeton Muslimi 2053.

NGJARJA E PESTË: Abdullah ibën Amër ibën Asi radijAllahu anhu thotë: “Nuk kishte njeri më të dashur për mua sesa Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe askush nuk ishte më madhështor në syrin tim se ai, megjithatë nuk kisha guxim ta ngrija shikimin në fytyrën e tij nga turpi ndaj tij. Sikur ndonjë njeri të më kërkonte t’ia përshkruaja fytyrën e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nuk do të kisha pasur mundësi.”<sup>[8]</sup>

NGJARJA E GJASHTË: Kur mushrikët e Mekës e lejuan Uthman ibën Affanin radijAllahu anhu që të bënte tavaf rreth Qabes kur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e kishte dërguar në Mekë, Uthmani u tha mushrikëve: “Kurrë nuk do të kisha bërë tavaf rreth Qabes pa bërë tavaf Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.”<sup>[9]</sup>

NGJARJA E SHTATË: Bera ibën Azibi radijAllahu anhu thotë: “Ndodhte që kalonte një vit dhe unë nga turpi dhe respekti ndaj Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem nuk e pyesja për gjëra që kisha nevojë, saqë shpresoja të vinte ndonjë beduin e ta pyeste Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem diçka (e ne të përfitonim nga pyetja e tij).”<sup>[10]</sup>

NGJARJA E TETË: Enes ibën Maliku radijAllahu anhu thotë: “Trokiste dera e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem (nga respekti i sahabëve) me majën e gishtërinjve.”<sup>[11]</sup>

NGJARJA E NËNTË: Sehl ibën Sa'di radijAllahu anhu thotë: “Isha në një tubim me vendasit e mi dhe përderisa u tregoja fragmente nga jeta e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, një grup prej tyre flisnin me njëri-tjetrin. Pastaj u thashë: “Shikoni ata, për Zotin, unë u flas atyre për Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe ata flasin me njëri-tjetrin. Vallahi do t’ju braktis dhe

kurrë më nuk do të kthehem.” I thanë: “Ku do të shkosh?” Tha: “Të bëj xhihad në rrugën e Allahut.”<sup>[12]</sup>

NGJARJA E DHJETË: Enes ibën Maliku radijAllahu anhu thotë: “Kur zbriti fjala e Allahut: *“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare”*”,<sup>[13]</sup> Thabit ibën Kajsi radijAllahu anhu tha: “Unë jam vallahi ai që çdoherë e kam ngritur zërin mbi zërin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe ja që frika ime u realizua. Allahu u hidhërua me mua dhe për këtë arsye zbriti këtë ajet.” Enesi thotë: “Nga frika dhe pikëllimi i madh iu zverdh fytyra. Pas këtij rasti Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem nuk e pa një kohë, pastaj pyeti sahabët për të dhe i thanë: “O i Dërguari i Allahut! Thabit ibën Kajsi po thotë: -Unë u bëra nga banorët e zjarrit sepse çdoherë ngrija zërin mbi zërin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.” Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: *“Jo, ai është nga banorët e xhennetit”*. Enesi tha: “Nga ajo ditë patëm rastin për së gjalli të shohim një njeri nga xhennedinjtë që ecte në mesin tonë.”<sup>[14]</sup>

Lexues i nderuar!

Ky sahab, shok i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nuk e ngrinte zërin e tij mbi zërin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem për shkak të mungesës së edukatës ndaj tij, por kishte një arsye. Ai kishte probleme dhe dobësi në të dëgjuarit e tij, zërat normalë të bisedave të rëndomta nuk kishte mundësi t’i dëgjonte si çdo njeri tjetër, ndaj për këtë arsye fliste me një ton pak më të lartë, ashtu sikurse edhe të tjerët flisnin me të në të njëjtën mënyrë. Megjithatë, edukata e tij e lartë bëri që ky sahab të mendonte se ajeti kishte zbritur pikërisht për të dhe që shkak që të bëhej nga banorët e zjar-

[8]Transmeton Muslimi 121.

[9]Senedi është sahih thotë Dhehebiu në “Sijeru A’lamin-nubela” 3\290.

[10]El-metalibul-alijeh” e ibën Haxherit (3\325) dhe thotë se senedi është sahih.

[11]Transmeton Buhariu në “El-Edebul-mufred” (1080) dhe senedi është sahih thotë shejh Albani në “Es-sahihah” 2092.

[12]Transmeton Taberaniu në “Mu’xhemul-kebir” (6\5866) me sened sahih.

[13]El-Hixhr: 2

[14]Buhariu 6\620 dhe 8\590 dhe Muslimi 1\110.

rit.

Ç'është themi sot për ata që ngrenë zërat, gjykimet, ligjet, politikat... mbi zërin dhe Sunnetin e Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem? Për ata që pa pikë turpi tallen me rrugën e tij, për ata që refuzojnë udhëzimin e tij ashtu siç refuzojnë udhëzimin e një njeriu të pavlerë në shoqëri? Mjerë për ta se çfarë i pret, nëse nuk pendohen!

O musliman! A nuk dëshiron të kesh edukatë shumë të lartë dhe përmbledhëse, edukatën e sahabëve, edukatën e cila do të kishte shmangur sa e sa sprova, fatkeqësi, trazira në ajër, tokë, det dhe shoqëri nuk do të ishin realizuar.

Po, për Zotin, është shumë i rrezikshëm privimi i muslimanit nga kjo edukatë!

Në anën tjetër, do të kishte qenë shumë mirësi e madhe stolisja me të. Kjo edukatë është se sahabët e Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem kur pyeteshin rreth ndonjë dispozite islame, nëse nuk kishin dije rreth saj apo kishin dyshime, qoftë edhe shumë të vogla, thoshin: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri!

O musliman! Për Zotin, nëse nuk ke dije, njohuri rreth fesë islame, mos hezito të thuash edhe ti "nuk e di". Nëse shokët e Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem qëllonte të mos dinin diçka nga Sunneti i Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem me gjithë ambicien e lartë dhe shoqërimin e afërt me të, që të mos u ikte asgjë nga udhëzimi i tij, atëherë si qëndron puna jote? Ti ke lindur 15 shekuj pas tij, aq më tepër mund të mos dish as gjuhën arabe dhe nuk ke pasur mundësi të shohësh as një për qind të literaturës islame e jo më t'i kesh lexuar ata libra. Ndoshta nuk ke shfletuar asnjë koleksion të haditheve profetike... a nuk është shumë më prioritar ta kuptosh hallin tënd dhe të mos japësh përgjigje pa pasur dije?

Edhe nëse ke lexuar me dhjetëra libra në gjuhën shqipe rreth fesë islame, përderisa nuk di gjuhën arabe nuk të lejohet të marrësh guximin dhe të flasësh për Islamin me bindjet e tua.

Jo, vallahi! Edhe nëse e ke babanë apo babagjyshin, mikun apo dikë në fis hoxhë apo haxhi, nuk të

lejohet një gjë e tillë. Kush ka thënë që dija dhe udhëzimi trashëgohet nga babai ashtu siç trashëgohet pasuria e shtëpia?

Dija dhe edukata islame mësohet dhe merret vetëm nga Kur'ani dhe Sunneti dhe nga shokët e Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem, shembuj të moralit të këtij ummeti.

Si përfundim po përmend një thënie të një dijetari shumë të madh, dijetar i cili nuk ka hadith dhe emri i tij thuajse nuk ekziston në zinxhirin e transmetimeve të tyre, Imam Muhamed ibën Shihab Zuhriu, Allahu e mëshiroftë, i cili pas kalimit të tërë jetës së tij në mësimin dhe studimin e haditheve profetike si konkluzion se ç'është dija islame ka thënë: "Vërtet dija islame është edukata e Allahut nëpërmjet së cilës Allahu e ka edukuar Pejgamberin sal-Allahu alejhi ve sel-lem dhe edukata e Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem, që ai e ka edukuar ummetin e tij me të. Dija është amaneti i Allahut për të Dërguarin e Tij, Muhamedin sal-Allahu alejhi ve sel-lem, që ta çojë në vend me besnikëri ashtu siç ia dorëzoi atij Allahu. Kush mëson diçka nga dija e pastër islame, le ta konsiderojë prijës të vetin dhe si argument mes tij dhe Allahut."<sup>[15]</sup>

Allahu e di më së miri. Allahu na i ndërtotfë zemrat tona me devotshmëri, gjuhët me falënderim, gjymtyrët vetëm ndaj Tij me përkushtim dhe askujt tjetër pa asnjë përjashtim.

*Literatura e konsultuar:*

- "El-isabeh fi temjizis-sahabeh" e ibën Haxherit.
- "Hurmetu ehlil-ilmi" e Muhamed Ismail El-Mukadem.
- "Sijeru A'lamin-nubela" e Dhehebiut.
- "Fadailus-sahabeh" e Imam Nesaiut.
- "El-ilma' ila ma'rifeti usulir-rivajeti ve takjidis-sema" e Kadi Ijadit.

*Përgatiti: AbdulMelik-Besfort MAXHUNI  
Zerka/Jordani*

[15] "El-ilma..." e Kadi Ijadit, faqe 213 me sened sahih



## PËRGJIGJE TË QARTA NDAJ DYSHIMEVE ME TË CILAT ARGUMENTOHET LEJIMI I

# MEVLUDIT

*Kjo gjë vërtetohet edhe nga fjala e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem që thotë: "Do t'i pasoni ata që kanë qenë para jush pëllëmbë për pëllëmbë dhe bërriyl për bërriyl. Edhe sikur të hynë në vrimën e hardhucës, edhe aty do t'i pasoni."*

### ORIGJINA E MEVLUDIT DHE ZHVILLIMI I TIJ

Prej bidateve më të mëdha që bëhet nga shumica dërmuese e muslimanëve është festimi i ditëlindjes së Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, madje kjo është bazë edhe për festimet e tjera që bëjnë për evlatë, të devotshmit, për prindërit dhe fëmijët.

Festimi i ditëlindjeve daton prej kohësh, herët dhe nuk mund t'u atribuohet vetëm muslimanëve apo ndonjë shoqërie duke përjashtuar tjetrën, pasi festimi i një gjëje të tillë është shfaqur dhe njohur që në kohët që i kanë paraprirë shpalljes së fundit.

Faraonët dhe grekët festonin për zotat e tyre. Të njëjtën gjë e hasim edhe te fetë e para. Më pas kjo traditë u mbart tek nazaretistët, të cilët i festonin ditëlindjet, por më e rëndësishmja për ta është lindja e Isait alejhis salam. Ata e bënë atë festë madhështore duke vepruar në të gjëra të shëmtuara, haramë të

ndryshme, si pirja e alkoolit, nën justifikimin ditë gëzimi dhe lumturie.

Me kalimin e kohës disa muslimanë e morën ditën e lindjes së Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem për festë duke pasuar me këtë nazaretistët,<sup>[1]</sup> të cilët ditëlindjen e Isait alejhis salam e bënë festë të përvitshme.

Pra, kjo është origjina ku e mbështesin festimin e datëlindjes së Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe për këtë es-Sehavij thotë: "Kur kryqtarët lindjen e Pejgamberit<sup>[2]</sup> të tyre e bënë festën më të madhe, pasuesit e Islamit kanë më përparësi në respektim."

Ky tekst posedon përngasim, prandaj festimi i lindjes së Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem bazën e ka nga nazaretistët dhe "kush i përngjan një populli, ai është prej tyre"<sup>[3]</sup>. Kjo gjë vërtetohet edhe nga fjala e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem që thotë: "Do t'i pasoni ata që kanë qenë para jush pëllëmbë për pëllëmbë"

[1] Të krishterët, por Allahu i quan nasara sipas vendit ku është rritur Isai alejhi salam dhe e drejtë është të quhen ashtu siç i ka quajtur Allahu në Kur'an dhe Resulullahu sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në Sunnet, pra nasara – nazaretistë, dhe jo me termin të krishterë, që rrjedh nga emri Krisht, emër i Isait alejhis sel-lem sipas Ungjillit të ndryshuar.

[2] Në realitet, ata Isain alejhi salam e besojnë për Zot e jo për Pejgamber dhe e drejtë ishte të thuhet për Zotin e tyre.

[3] Transmeton Ebu Davudi në sunenin e tij (4031) dhe të tjerë. Ibën Haxheri thotë në El Fet'h senedi i hadithit është i mirë. E ka bërë këtë hadith sahih Albani në Irvaul Galil 5/109

lëmbë dhe bërryl për bërryl. Edhe sikur të hynë në vrimën e hardhucës, edhe aty do t'i pasoni.”<sup>[4]</sup> Pra, kjo është origjina e mevludit.

## TË PARËT QË SHPIKËN MEVLUDIN NË ISLAM

Kanë rënë në konsensus dijetarët të cilët e mohojnë mevludin se një festim i tillë konsiderohet bidat dhe njëkohësisht thonë se Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem nuk e ka festuar lindjen e tij dhe as nuk ka urdhëruar apo rekomanduar për një gjë të tillë. As sahabët radijallahu anhum, tabi'inët,<sup>[5]</sup> tabitabi'inët, të cilët ishin njerëzit më të mirë dhe më të përkushtuarit për pasimin e Sunnetit të Resulullahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, nuk e festuan. Në tre shekujt për të cilët Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka dëshmuar se janë shekujt më të mirë nuk u festua ditëlindja e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, madje ata as që e kanë ditur një gjë të tillë. Në fund të shekullit të katërt hixhri, në Egjipt u formua shteti fatimij<sup>[6]</sup> dhe u shfaq për herë të parë në historinë e muslimanëve festimi i lindjes së Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Këtë e thotë el Makrizij kur përmend ditët e kalifëve fatimij, të cilët e festonin ditën e mevludit dhe e bënë festë. Prej mevludëve më kryesorë ishin gjashët: mevludi i Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, i Aliut radijallahu anhu, i Hasenit, Husejnit dhe i Fatimes radijallahu anhum si dhe i kalifit që ishte prezent.<sup>[7]</sup>

## DYSHIMET E ATYRE QË MUND OHEN TË ARGUMENTOJNË LEJIMIN E MEVLUDIT DHE PËRGJIGJJA NDAJ TYRE

Nuk ekzistojnë fakte të sakta që argumentojnë festimin e lindjes së Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem as nga Kur'ani, as nga Sunneti, as nga gjurmët e sahabëve, as nga imamët e katër medhhebeve dhe as nga dijetarët e tjerë në të kaluarën dhe sot, me përjashtim të atyre që u bazuan në metodologjinë e të argumentuarit me fakte sipas metodës që kundërshton argumentimin udhëzues nën dritën e argumenteve të Kur'anit dhe Sunnetit. Përkundrazi, nga drita e argumenteve të Kur'anit dhe Sunnetit sqarohet dhe kuptohet moslejimi i festimit të mevludit dhe tregohet se mevludi dhe gjëra të ngjashme me të i takojnë kapitullit të bidateve që dërgojnë në humbje, kurse humbja është në zjarr. Mirëpo ata që deklarojnë përmes fetyrave dhe ligjëratave se lejohet mevludi, i mbështesin qëndrimet e tyre në dyshime duke thënë se në to aludohet për lejimin e mevludit dhe se nuk është i ndaluar një veprim i tillë. Këto mendime dhe dyshime ata i kanë përhapur te shumica e njerëzve. Në vazhdim do të sqarojmë dhe elaborojmë bindjet dhe dyshimet e tyre për të treguar të vërtetën në bazë të argumenteve të shëndosha.

## DYSHIMI I PARË

Sujuti tregon nga Ibën Haxheri dhe thotë: “Është pyetur shejhul islam, hafizi i shekullit Ebul Fadël Ibën Haxher për praktikimin e mevludit dhe është përgjigjur: “Origjina e praktikimit të mevludit është bidat për arsye se nuk është transmetuar nga asnjëri prej të parëve të devotshëm nga tre shekujt e parë. Mirëpo, megjithatë mevludi ka të mira dhe të këqija. Kush merr të mirat dhe largon të këqijat, atëherë është bidat i mirë<sup>[8]</sup> dhe nëse nuk veprohet kështu, atëherë

[4] Transmeton Buhari në sahihun e tij (7320) dhe Muslimi në sahihun e tij (2669).

[5] Nga kjo gjeneratë ishte edhe imami i nderuar Ebu Hanife rahimehullahi teal.

[6] Këta janë batinitë, fraksion që i adresohet Islamit.

[7] Fatimitë batini menduan se po shfaqnin dashuri për Resulullahun sal-IAllahu alejhi ve sel-lem si dhe për një pjesë të familjes së tij, por në realitet kjo dashuri e batinive si në të kaluarën edhe sot është e ndërtuar në bindje kufri, mosbesimi që kundërshton fundamentet e Islamit burimor.

[8] Mendimi i Hafidh Ibën Haxherit rahimehullahi, se ka bidat të mirë, kundërshton hadithin e vërtetë që Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “...çdo bidat është humbje...” dhe disa edhe në këtë mesele janë munduar të fusin dyshime duke thënë se hadithi ka për qëllim se në përgjithësi bidatat të dërgojnë në humbje, por ka edhe bidate të mira. Por për këtë duhet të ketë argument që veçon ndonjë bidat të mirë, porse nuk ekzistojnë argumente as nga Kur'ani e as nga Sunneti i të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem që aludojnë për këtë mendim. Ata janë munduar të argumentojnë me pjesën e ajetit “(era) që shkatërron çdo send” duke thënë se era nuk ka shkatërruar çdo send; edhe pse citohet në ajet “çdo send”, qëllimi është shkatërrim në përgjithësi e jo në tërësi. Ky argument është mashtrim i qartë, i sajuar për lexuesit, sepse nga ajeti nuk kuptohet kjo, por nëse e lexojmë ajetin në tërësi do kuptojmë se era ka shkatërruar çdo send që ka urdhëruar Allahu, ashtu siç sqarohet në ajetin ku Allahu thotë: “... (era) që shkatërron çdo send me urdhrin e Zotit të saj. Dhe aguan ashtu që nuk shihet tjetër përveç banesave të tyre. Ashtu Ne e ndëshkojmë popullin kundërshtar.” (El Ahkaf: 25) Pra, era ka shkatërruar çdo send që ka urdhëruar Allahu të shkatërron dhe nuk është shkatërruar ajo që Allahu nuk ka urdhëruar të shkatërron. Prandaj mendimi se bidatat ndahen në të mira dhe të këqija është mendim i gabuar dhe i papranueshëm. Ajo që e përforcon mendimin se bidatat në tërësi janë humbje dhe se nuk ka bidate të mira është fjala e sahabit të nderuar Abdullah ibën Umerit radijallahu anhuma, që ka thënë: “Çdo bidat është humbje, edhe nëse njerëzit e shohin për të mirë.” Transmeton Lalekai, numër 126, Ibën Batta, 205, Bejhëkiu në “El med'hal ilas-Sunen” 191 dhe Ibën Nasër në “Es-Sunneh”, numër 70, me sened sahih. Shiko “Ilmu Usulil Bidai” dijetarit të nderuar Ali ibën Hasen ibën Ali ibën Abdulhamid, Allahu e ruajti, faqe 92). Imam Shatibiu në komentimin që i bën hadithit “çdo bidat është humbje” thotë: “Ky hadith nuk bën dallim në vendim mes bidatit me bidat tjetër sepse në hadith ka përgjithësim dhe përgjithësimi nuk mund t'i veçohet diçka përveçse me përjashtim. Po ku qëndron përjashtimi këtu?” Muxhtemaur-Rrahbanij, faqe 97-98, marrë nëpërmjet “Ilmu Usulil Bidai”, faqe 91.

nuk bën. Unë këtë e bazoj në hadithin e vërtetë. Kur Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem u vendos në Medinë, i gjeti çifutët duke agjëruar ditën e Ashuras dhe i pyeti për këtë dhe iu përgjigjën se “kjo ishte dita kur Allahu fundosi Faraonin dhe e shpëtoi Musain, prandaj ne e agjërojmë këtë, si falënderim për Allahun e Madhëruar”.<sup>[9]</sup> Ne përfitojmë nga kjo të praktikuarit e falënderimit për Allahun sepse na ka begatuar me një ditë të veçantë dhe kjo ditë përsëritet çdo vit. Falënderimi ndaj Allahut realizohet me lloje të ndryshme ibadetesh, si: sexhdet, agjërimi, sadakaja dhe leximi i Kur'anit. Cila dobi është më madhështore se dobia e ardhjes së këtij Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, i cili është Pejgamberi i mëshirës? Pra, duhet të merret kjo ditë e veçantë që të përputhet me ngjarjen e Musait alejhis salam në ditën e Ashuras.”

### PËRGJIGJJA NDAJ KËTIJ DYSHIMI

Së pari: Ibën Haxheri rahimehullah e sqaroi në fillim të thënies së tij se origjina e praktikimit të mevludit është bidat dhe nuk është transmetuar nga asnjëri prej të parëve të devotshëm nga tre gjeneratat e para dhe kjo fjalë nga thënia e Ibën Haxherit është e mjaftueshme për mohimin e mevludit. Po të ishte i mirë, kishin për të paraprirë në të sahabët, tabi'inët dhe imamët e udhëzimit pas tyre dhe këta janë njerëzit më të mirë dhe prijës në pasimin e Resulullahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Si mund ta humbin ata këtë gjë?!

Së dyti: Të argumentuarit e Ibën Haxherit, që e lejon praktikimin e mevludit duke u mbështetur në hadithin e agjërit të Ashuras, nuk mund të bashkohet me fillimin e fetvasë së tij, që thotë se praktikimi i mevludit është bidat dhe se nuk është transmetuar nga të parët e devotshëm. Andaj mosveprimi i të parëve të devotshëm me këtë argument, në këndvështrimin të cilin e kanë kuptuar ata që kanë ardhur pas tyre, bën që kuptimi i Ibën Haxherit nuk mund të konsiderohet si i drejtë. Edhe sikur të ishte ky hadith argument për mevludin, të parët e devotshëm do të ishin të parët që do ta kuptonin dhe praktikonin mevludin duke e mbështetur në hadithin e Ashuras. Së treti: Argumentimi i mevludit me hadithin e

agjërit të ditës së Ashures është i papranueshëm për arsye se adhuret janë të bazuara në shariat (Kur'an dhe Sunnet) dhe në pasimin e drejtë të rrugës së Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe jo në dëshira dhe shpikje. Për këtë arsye, shejhul Islam Ibën Tejmije thotë: “Adhuret janë të bazuara në shariat dhe pasim (të Sunnetit) e jo në dëshira dhe shpikje sepse Islami ngrihet mbi dy baza:

E para: Ta adhurojmë Allahun një, të vetmin dhe të pashoq.

E dyta: Ta adhurojmë Atë ashtu siç e ka legjitimuar gjuha e Resulullahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe jo me dëshira dhe bidat. Allahu thotë: “Pastaj, Ne të vumë ty në një rrugë të drejtë të fesë (shariat), pra ti ndiqe atë e mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë.”<sup>[10][11]</sup> Nuk i lejohet asnjërit që ta adhurojë Allahun jo ashtu siç e ka legjitimuar i Dërguari sal-IAllahu alejhi ve sel-lem kur flitet për vaxhibe ose mustehabe dhe assesi të adhurohet me gjëra të shpikura (bidate).

Së katërti: Agjërimin e ditës së Ashuras e ka praktikuar Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe ka inkurajuar për të, ndryshe nga festimi i ditëlindjes së tij. Ai sal-IAllahu alejhi ve sel-lem nuk e bëri këtë dhe as nuk inkurajoi në të dhe sikur festimi i mevludit dhe të bërit e tij festë të ishte prej gjërave të vlefshme më të vogla, Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem do t'ia kishte sqaruar ummetit të tij pasi ai na ka inkurajuar për çdo të mirë dhe na ka tërhequr vërejtjen dhe na ka ndaluar nga çdo e keqe. Bidati është prej të këqijave që na i ka ndaluar dhe na ka tërhequr vërejtjen për to. Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Nuk ka mbetur asnjë gjë që ju afron tek xhenneti dhe që ju largon nga zjarri që të mos ju jetë sqaruar.”<sup>[12]</sup> Me këtë sqarohet kotësia e këtij dyshimi dhe mbështetja e padrejtë në hadithin e Ashuras.

*Libri: “El e'jadu ve etheruha alel muslimin”,  
faqe 283,*

*Dr. Sulejman ibën Salim es-Suhejmi  
Versionin e shkurtuar me ndryshime e shitesa përgatiti:  
Adem AVDIU  
Gjakovë/Kosovë*

[9] Transmeton Buhariu në “Sahihun” e tij 4/244, numër 2004.

[10] El Xhathije: 18

[11] “Mexhmu'ul Fetava” 1/80.

[12] Shiko në “El Itmam” 21399 dhe në “Er-Risaleh” faqe 93, nga Imam Shafiu me verifikim të shejh Ahmed Shakirit si dhe në “Miftahul Xhenneh”, faqe 32, nga Sujutiu, me sqarime të Bedër el Bedër. Shejh Ali el Halebi, Allahu e ruajtë, thotë se senedi i këtij hadithi është sahih. Shiko për këtë “Ilmu usulil Bidai” (19).



# OBLIGUESHMËRIA E TË DISTANCUARIT NGA TË PËRFOLURIT E NDERIT TË TË TJERËVE

*Ibnul Kajjimi ka thënë: “Kush është i preokupuar me xhennetin dhe Firdeusin nuk ka kohë të merret me thashetheme. Kush distancohet nga njerëzit, shpëton nga të këqijat e tyre.”*

**O** ju të cilët keni besuar, kijeni frikë Allahun ashtu siç duhet dhe mos vdisni ndryshe veçse duke qenë muslimanë.”<sup>[1]</sup>

O ju muslimanë, nga të metat e mëdha dhe sëmundjet e rënda që kanë prekur shoqëritë muslimane është përhapja e thashethemeve, të cilat nuk bazohen në ndonjë fakt të prerë dhe nuk ngrihen mbi ndonjë argument të qartë.

Kjo është një portë fitneje dhe një sprovë e madhe për Islamin dhe muslimanët për faktin se përhapja e fjalëve të pabaza shkakton prishjen e zemrave, çoroditjen e mendjeve, shkatërrimin e vëllazërisë mes muslimanëve, sjell fatkeqësi dhe të këqija të panumërta e të pamasa.

Nuk i takon një shoqërie islame të angazhohet me fjalë që përhapen dhe biseda që qarkullojnë, të cilat kanë si mbështetje të vetme paragjykimin, hamendësimin, supozimin, duke mos pasur kurrfarë verifikimi apo qartësimi. Kjo shkakton dëme dhe mëkate të mëdha. Për këtë arsye, zotëria i njerëzisë, Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem na ka ndaluar qartazi në lidhje me këto parime të shëmtuara dhe sjellje të devijuara, siç transmetohet në dy sahihët, ku thuhet: “Vërtet Allahu urren për ju thashethemet, pyetjet e shumta dhe shpërdorimin e pasurisë.”<sup>[2]</sup>

Ibnul Kajjimi ka thënë: “Kush është i

[1] Alu Imran: 102

[2] Buhari 7292 dhe Muslimi 1342

preokupuar me xhennetin dhe Firdeusin nuk ka kohë të merret me thashetheme. Kush distancohet nga njerëzit, shpëton nga të këqijat e tyre.”

O ju vëllezër muslimanë!

Shenjtëria e nderit në Islam është e madhe, prandaj konsiderohet zullumi më i madh cenimi i nderit dhe personalitetit të ndonjë muslimani dhe shkëlja e të drejtës së tij vetëm e vetëm për shkak të pasioneve të verbra apo ndjekjes së dikujt në mënyrë naive, fanatike dhe të rëndomtë. Është saktësuar se Profeti sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Kamata është në 72 nivele. Niveli më i ulët është si bërja incest me nënën, ndërsa niveli më i rëndë është cenimi i nderit (personalitetit) të vëllait.”* Në hadithin tjetër thotë: *“Kamata më e rëndë është ofendimi i ndereve (personaliteteve të njerëzve).”*

Detyra e çdokujt që i trembet qëndrimit para Zotit të tij, që ia ka frikën momentit të daljes para Allahut, është që t’i largohet përzierjes me thashethemet e thashethemexhinjve, të mos e angazhojë veten me gjëra që e dëmtojnë fenë e tij dhe që e bëjnë të rrezikojë me zemërimin e Zotit të tij.

Transmetohet në hadithin e saktë, të cilin e përcjell Ahmedi dhe Ebu Daudi, se Profeti sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Kush thotë për një besimtar atë që nuk është e vërtetë, Allahu do ta fusë të banojë në ‘radgatul habal’ (qelbi dhe lëngu që del nga banorët e zjarrit) derisa të shlyejë atë që ka thënë.”* Po ashtu në të dy sahihët transmetohet thënia e Profetit sal-lallahu alejhi ve sel-lem: *“Kush i beson Allahut dhe Ditës së Fundit, le të thotë fjalë të mira ose le të hes-*

*htë.”* Gjithashtu, transmetohet tek Taberaniu me zinxhir hasen se Profeti sal-lallahu alejhi ve selem ka thënë: *“Mos fol me gjuhën tënde veçse të mira dhe mos e zgjat dorën tënde veçse tek diçka e mirë.”*

Vëllezër muslimanë! Nga mëkatet e qarta është edhe nxitimi në përhapjen e lajmeve që nuk bazohen në fakte dhe ndjekja e bisedave që nuk kanë argumente. Zoti ynë thotë: *“O ju të cilët keni besuar, nëse vjen ndonjë mëkatar i prishur me ndonjë lajm, jini të qartë (verifikojeni), ashtu që të mos cenoni një popull padrejtësisht nga injoranca e më pas të pendoheni për atë që bërtë.”*<sup>[3]</sup>

Dijetarët e kanë theksuar fort faktin se nga shenjat e budallallëkut është mosverifikimi, gjurmimi i lajmeve të sajua, i hamendësimeve të kota, gjuetia e bisedave të trilluara, paragjykimi i muslimanëve dhe interpretimi sipas supozimeve të mbrapshta dhe të dyshimta. Vëllezër muslimanë! Rruga e besimtarëve të mirë, të devotshëm dhe të bindur ndaj Zotit të tyre është përmbajtja ndaj parimeve islame, siç ua ka mësuar Krijuesi i tyre. Ndër të tjera këtu futet mospërzierja në thashetheme me thashethemexhinjtë.

Qëndrimi i muslimanëve është zbatimi i fjalës së Allahut: *“Kur e dëgjuan shpifjen, pse nuk menduan mirë besimtarët dhe besimtarët, njësoj siç do dëshironin për vetet e tyre, e të thoshin: Kjo është shpifje e qartë!”*<sup>[4]</sup>

Nga ky ajet kuptohet qartë ndalesa nga përfshirja në përhapjen e lajmeve të pavërteta dhe distancimi nga lajmet që nuk tregojnë realitetin, bazuar në ajetin kur’anor: *“Ata të cilët duan që të përhapet imoraliteti në mesin e besimtarëve, do kenë*

[3] El Huxhurat: 6

[4] En Nur: 12

*dënim të dhimbshëm në këtë dunja dhe në ahiret.*”<sup>[5]</sup> Dijetarët kanë thënë: “Ky kërcënim ka të bëjë me ata që thjesht e dëshirojnë përhapjen e diçkaje të tillë.” Çfarë mund të thuhet për ata që e kanë marrë përsipër sajimin e shpifjes dhe përhapjen e saj?!

Vëllezër muslimanë! E keni për detyrë të distancoheni nga e kota në fjalë, në të gjithë gamën e saj, dhe nga vulgariteti në të gjitha format që shfaqet, si për shembull nxitimi për ofendimin e nderit dhe personalitetit të muslimanëve në fenë dhe në besueshmërinë e tyre pa asnjë të drejtë apo fakt. Në lidhje me robërit e shpëtuar Allahu thotë: *“Janë ata të cilët distancohen nga e kota (në thënie dhe vepra).”*<sup>[6]</sup> Dhe: *“E kur ata dëgjojnë diçka të kotë, i kthejnë kurrizin (distancohen, e shpërfillin atë).”*<sup>[7]</sup> Nxjerrja e vendimeve për ndonjë musliman pa qartësuar shkaqet e konsiderueshme fetarisht, pa sjellë gjëra të prera, as fakte të sakta, as argumente të qarta është një gjë shumë e shëmtuar në Islam, e cila shkakton sherr të rrezikshëm dhe fatkeqësi të madhe.

Kush i shmanget parimeve fetare dhe rregullave fisnike ka rënë në dërdëllitje të kota dhe në budallallëk të shprehur, duke u shndërruar në ofendues, tallës me fjalë dhe vepra, agresor ndaj muslimanëve, i devijuar nga rruga e drejtë dhe lënës i drejtësisë së paanshme.

Dije mirë, o ti kritikues, se nderi i muslimanëve është gropë nga gropat e zjarrit të xhehennemit, ndaj ki kujdes se mos qëndron në buzë të asaj grope, siç ka thënë Ibën Dekik el Ijdi.

Dije se nëse ti i bën xherh(kritikim) një

muslimani pa e verifikuar çështjen dhe pa qenë i matur, ke ngritur një akuzë ndaj një muslimani të pafajshëm dhe e ke damkosur me një damkë të keqe, e cila do i ngelet padrejtësisht përgjithmonë, por edhe mëkati i kësaj veprë do të të ngelet ty përgjithmonë.

Nga llojet më të rënda të gibeit, më të dëmshmet, më të shëmtuarat dhe më shkaktaret e belave, por njëkohësisht që meriton dhe ndëshkimin më të ashpër, është ajo që shkruhet megjithëse nuk ka kurrfarë baze apo mbështetjeje. Përkundrazi, është vetëm injorancë e theksuar në lidhje me realitetin e gjërave, ekstremizëm i tejskajshëm në paragjykimin e gabuar ndaj muslimanit. Kjo gjë e shkruar më pas lexohet nga të gjithë, por mos harro se banorët e qiellit dhe të tokës do të jenë dëshmitarë kundër teje për atë që ke shkruar.

O ti që bën këtë lloj gabimi! Kujto atë që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në dy sahihet: *“Njeriu flet një fjalë duke mos i dhënë rëndësi, por me të zhytet në zjarr në një distancë më të largët se ndërmjet lindjes dhe perëndimit.”* Le të përkujtojë muslimani se Allahu do ta pyesë për dëgjimin, shikimin, zemrën, për atë që ka thënë. Dije se Allahu është Mbikëqyrësi yt, Dëshmues i thënieve dhe veprimeve të tua.

Dije se e vërteta si në këtë dunja edhe në ahiret do triumfojë, do shtohet dhe lartësohet, ndërsa e kota do poshtërohet, ulet dhe zhduket. Shpifja dhe trillimi sado që mund të fryhen dhe të lartësohen në horizont duke u përhapur mes muslimanëve, në të vërtetë po e tërheq të zotin e saj

[5] En Nur: 19

[6] El Mu'minune: 3

[7] El Kasas: 55

poshtë në humnerë, po e zhyt në përfundimin e keq si në dunja edhe në ahiret.

Të gjithë ne duhet t'u përmbahemi kritereve të përcaktuara me shariat, të sjellja nga Profeti ynë, Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kritere që përfshijnë çdo fushë, edhe lajmet që përhapen. Gjithashtu duhet të kemi gjithmonë parasysh mbikëqyrjen e Allahut, të Gjithëpushtetshmit, Ngadhënjyesit.

Imam Ahmedi ka thënë: *"Nuk kam parë dikë që të ketë folur për njerëzit e të mos ketë rënë edhe vetë."*

Le të sjellë ndër mend dhe le të mbështetet në diçka të qëndrueshme ai që e lëshon lapsin apo gjuhën e tij në xherh dhe ofendim me fjalë të pabazuara, e jo të flet nga padituri rreth gjendjes konkrete duke mos paraftuar siç duhet situatën reale, le ta dijë se është duke bërë zullum dhe duke shkelur të drejtën e tjetrit. Le të ketë frikë për veten e tij nga ndonjë dua që udhëton natën, ndërkohë që ai është i shkujdesur, sepse Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ruaju nga lutja e atij që i është bërë padrejtësi sepse nuk ka pengesë mes saj dhe Allahut."*

Të vërtetën ka thënë poeti:

*Zullumqarit i vërtiten dhe grumbullohen të zezat*

*Sepse Allahu e ka vendosur që zullumi t'i shkatërrojë të zotët e vet.*

Allahu ju bekoftë ju dhe mua me Kur'an dhe na bëftë dobi me udhëzimin dhe daluesin e të vërtetës nga e kota që gjendet në të. I thashë këto fjalë dhe i kërkoj falje Allahut për vete dhe ju dhe për të gjithë muslimanët. Kërkojini falje sepse Ai është Mëkatfalës, Mëshirues.

(Pjesa e dytë e hutbes)

E më pas:

O ju muslimanë, ju porosis ju dhe veten time me devotshmërinë ndaj Allahut, fshehtas dhe haptas, në dukje dhe në brendësi, në fjalë dhe në vepra. O ti musliman! Lumturia dhe shpëtimi në çdo sprovë është të zbatosh fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"Frenoje gjuhën tënde, të të mjaftojë shtëpia jote dhe qaj për mëkatet e tua."*

Transmeton Ibën Sa'di në "Et-Tabakat" nga Mutarrif bin Abdullah ibën Shihir se ai tha: "Kam ndenjur shtatë vjet në kohën e fitnes së Ibën Zubejrit duke mos ndjekur lajme dhe duke mos kërkuar që të marr lajme prej saj dhe megjithatë nuk shpëtova paq (nga përgojimi)."

Ndaj, o musliman, si është gjendja e atij që përfshihet me thashethemexhinjtë dhe përflet nderin e muslimanëve?!

Nëse dëgjon dikë që sulmon një musliman, mos e beso, por verifikojë, tregohu i matur, kërko të vërtetën, ndiq të pastrën dhe mos u bëj palë ndihmuese në përhapjen e informacioneve dashakeqe që qarkullojnë apo lajmeve të pabazuara sepse në hadith Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"I mjafton njeriut si e keqe që të flasë çdo gjë që dëgjon."*

E në fund, dijeni se Allahu na ka urdhëruar me një gjë madhështore, e cila është shtimi i salavateve dhe selameve për Profetin fisnik sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

*Hutbe e mbajtur nga shejhu i nderuar Husejn Ali Shejh në xhaminë e Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.*

*Përshtati: Shuajb REXHA  
Tiranë/Shqipëri*

# SHERIATI ËSHTË NDËRTUAR MBI DY BAZA

*Nëse e kundërshtojnë sheriatin, shfuqizohen dhe peshorja e kushteve është e përgjithshme me fjalët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili thotë: "Muslimanët u përmbahen kushteve të tyre, me përjashtim të kushtit që ndalon të lejuarën apo lejon të ndaluarën."*

Sheriati është ndërtuar mbi dy baza: sinqeriteti ndaj Allahut dhe pasimi i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Këto janë dy bazat kusht për pranimin e çdo veprë fetare, qoftë e dukshme si fjalët e gjuhës dhe punët e gjymtyrëve, apo e veprave të brendshme si ato të zemrës. Allahu subhanehu ve teala thotë: **"Vini re! Adhurimi i sinqertë është vetëm ai për Allahun..."**<sup>[1]</sup>  
**"E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij..."**<sup>[2]</sup>

Fenë e ka sqaruar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në hadithin e Xhibrililit: "Shtyllat e Islamit janë pesë, bazat e imanit janë gjashtë dhe imani më i lartë dhe i vërtetë është ihsani (bamirësia), i

cili është baza e veprave të zemrës."<sup>[3]</sup>

Këto çështje domosdo duhet të jenë të sinqerta vetëm për Allahun duke synuar me këto Fytyrën e Zotit, kënaqësinë dhe shpërblimin e Tij. Po ashtu këto gjëra domosdo duhet të merren prej Kur'anit dhe Sunnetit. Allahu subhanehu ve teala në lidhje me pasimin e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: **"...e atë që ju jep i Dërguari merreni e atë që ju ndalon largojuni..."**<sup>[4]</sup>, ndërsa duke i përmbledhur të dyja bazat në një ajet thotë: **"Kush ka fe më të mirë se ai që sinqerisht i është bindur Allahut dhe duke qenë bamirës..."**<sup>[5]</sup> "Esleme vexh'hehu" do të thotë i ka bërë me sinqeritet veprat e tij, vetëm për Allahun, qofshin vepra të dukshme apo të brendshme.

[1] Zumer: 3.

[2] El Bejjineh: 5.

[3] Shiço hadithin e Xhibrililit. Transmeton Buhariu në "Sahihun" e tij në "Kitabul Iman" me titull "Sualu Xhibrilun-Nebij sal-Allahu alejhi ve sel-lem 50" dhe Muslimi në "Sahihun" e tij nr:9".

[4] El Hashër: 7.

[5] En Nisa: 125.

“Ve huve Muhsin” domethënë ai është bamirës në këtë nënshtrim, duke qenë në të pasues i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. I Lartmadhëruari në shumë ajete thotë: ***"Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit..."*** [6]. Prandaj ajo vepër që i bashkon këto dy cilësi në vetvete, vetëm ajo është e pranuar, ndërsa kur mungojnë këto apo njëra prej tyre, atëherë kjo vepër i refuzohet pronarit të saj dhe ai hyn në fjalën e Allahut ku thotë: ***"E Ne i kthehem i ndonjë veprë që e bënë ata dhe e bëjmë atë hi e pluhur."*** [7] Allahu subhanehu ve tealë duke bërë dallimin mes të sinqertëve dhe atyre që punojnë vetëm për t'u dukur në sy të tjerëve thotë: ***"E shembulli i atyre që pasurinë e vet e japin nga bindja e tyre e duke kërkuar kënaqësinë e Allahut i përngjan një kopshti në një rrafshnaltë, që i bie shi i madh dhe ai jep frytë të dyfishta..."*** [8] Dhe thotë: ***"Edhe ata që japin pasurinë e tyre për sy e faqe të botës e nuk e besojnë Allahun as Ditën e Fundit. E ai që e ka shok djallin, ai pra është shok i shëmtuar."*** [9] Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në lidhje me hixhretin (emigrimin), që është prej veprave më të vlefshme, thotë: ***"Kush e bën hixhretin e tij për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, hixhreti i tij është tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Ky është i sinqerti. Dhe kush e bën hixhretin e tij për këtë botë që të arrijë të mirat e saj apo për t'u martuar me ndonjë femër, hixhreti i tij është për atë që bëri hixhret."*** [10] Kur u pyet Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem për personin që lufton për trimëri, për fanatizëm ose për plaçkë lufte, se cili prej këtyre e bën luftën për rrugën e Allahut? Tha: ***"Kush lufton për të qenë fjala e Allahut më e larta, ai është në rrugën e Allahut."*** [11] Kush e ka qëllimin në xhihadin e tij qoftë me fjalë apo vepër për ta ndihmuar të vërtetën, ai është i sinqerti. E kush ka për qëllim tjetër synim, atij i takon ajo që ka pasur për qëllim dhe vepra e tij

nuk është e pranuar. Allahu subhanehu ve te alë në lidhje me ato vepra që u mungon pasimi thotë: ***"Thuaj (o Muhamed): A t'ju informoj për më të dëshpëruarit në veprat e tyre? Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë duke bërë mirë."*** [12] Dhe thotë: ***"E nëse ata nuk të përgjigjen ty, atëherë dije se ata ndjekin vetëm dëshirat e veta. E kush është më i humbur se ai që ndjek dëshirat e veta duke mos pasur udhëzim prej Allahut?..."*** [13] Pra, edhe nëse të gjitha veprat e mira praktikohen nga ai që i bën për sy e faqe, ato janë të kota sepse nuk kanë sinqeritet. Ne e dimë që vepra nuk mund të jetë e mirë pa sinqeritet, por edhe veprat që njeriu i bën për hir të Allahut, por duke mos qenë të legjitimuara, janë të kota sepse u mungon pasimi i Sunnetit. Nga ana tjetër, të kota janë edhe bindjet që kundërshtojnë atë që është në librin e Allahut dhe Sunnetin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, si p.sh. bindjet e pasuesve të bidatit. E gjithë kjo hyn në fjalën e tij: ***"Vërtet veprat vlerësohen sipas qëllimit dhe çdo person shpërblehet për atë që ka për qëllim..."*** [14] Gjithashtu Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: ***"Kush vepron një punë që nuk është prej fesë sonë, ajo është e refuzuar."*** [15] Hadithi i parë është peshorja e veprave të brendshme, ndërsa i dyti peshorja e veprave të shfaqura, të dukshme, kurse sinqeriteti për Allahun kërkohet në çdo gjë. Argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti e obligojnë atë dhe tregojnë vlerën dhe rezultatet e tij si dhe asgjësimin e veprave në mungesë të tij. Ndërsa vetë qëllimi i veprës, edhe pse duhet bërë në çdo punë, në realitet bëhet prej çdo vepruesi që logjikon dhe mendon, pasi qëllimi është vetë synimi dhe çdo i mençur ka për qëllim punën që vepron dhe punon. Për këtë arsye sheriat i jep rëndësi të madhe realizimit dhe pastrimit të qël-

[5] En Nisa: 125.

[6] El Maide: 92.

[7] El Furkan: 23.

[8] El Bekare: 265.

[9] En Nisa: 38.

[10] Transmeton Buhariu në "Sahihun" e tij në "Bedul Vahi 1" dhe Muslimi në "Sahihun" e tij në "El Imareh bab kavluhu salallahu aljehi ve selem: "In-Nemel Eamalu bin-nijeh 1907".

[11] Transmeton Buhariu në "Sahihun" e tij në "El Ilm bab Men se'ele ve huve kaimun 123" dhe Muslimi në "El Imareh bab Men Katehi li Tekune Kelimetull-Ilahi hijel Ulja 1904".

[12] El Kehf: 103-104.

[13] El Kasas: 50.

[14] Për transmetimin e pjesës së këtij hadithi referoju fusnotës 10.

[15] Me këtë tekst e transmeton Muslimi në "Sahihun" e tij në "El Akdijeh bab Nakdul Ahkamul Batileh 1718" dhe mutfekun alejhi (në Buhari dhe Muslim) është me tekst: "Kush shpik në fenë tonë çfarë nuk është prej saj, ajo është e refuzuar." Transmeton Buhariu në "Es-Sulh bab Idha Istalahu ala Emrin Xhur 2697" dhe Muslimi siç e theksuam.

limit nga çdo njollë. Në këtë bazë hyjnë të gjitha adhurimet dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore. Të gjitha veprimet, qofshin ato veprime tregtie, qiradhënieje, mes kompanive apo të tjera dhe janë sipas pajtimit të palëve, mirëpo janë të ndaluara sipas legjislacionit fetar, atëherë janë të ndaluara dhe nuk merret parasysh kontrata e arritur me dëshirë prej tyre sepse pajtimi (në kontratë) është i kushtëzuar nga kënaqësia e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Kjo vlen edhe për dhuratat të cilat i ka ndaluar Allahu dhe Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, si p.sh. të veçarit e disa fëmijëve prej të tjerëve apo prioriteti në dhënie, testament dhe trashëgimi. *"Nuk ka testament për atë që trashëgon"*<sup>[16]</sup>.

Edhe kushtet për vakëfet nuk duhet të jenë në kundërshtim me sheriati. Nëse e kundërshtojnë sheriati, shfuqizohen dhe peshorja e kushteve është e përgjithshme me fjalët e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, i cili thotë: *"Muslimanët u përmbahen kushteve të tyre, me përjashtim të kushtit që ndalon të lejuarën apo lejon të ndaluarën."* (Transmetojnë Ehlus-Sunen<sup>[17]</sup> nga Auf ibën Maliku<sup>[18]</sup>)

E tillë është edhe çështja e kurorëzimit, kushtet, shtyllat e saj, e lejuara dhe e palejuara në të. Shkurorëzimi, kthimi i së lëshuarës në kurorë dhe të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me këto duhen zbatuar në përputhje me sheriati dhe nëse nuk ndodh kjo, atëherë janë të refuzuara. Për sa u përket betimeve dhe zotimeve, njeriu betohet vetëm për Allahun apo për ndonjë cilësi prej cilësive ose ndonjë emër prej emrave të Tij. *"Kush zotohet se do t'i nënshtrohet Allahut, le t'i*

*nënshtrohet Atij. E kush është zotuar se do të bëjë mëkat ndaj Allahut, të mos bëjë mëkat ndaj Tij.*"<sup>[19]</sup> Për ndryshimin e betimit Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Kush betohet për diçka dhe sheh diçka tjetër më të mirë se kjo, le të bëjë atë që është më e dobishme dhe le të shpagojë për betimin e tij."*<sup>[20]</sup> Gjykimet, sqarimet dhe çfarë ka të bëjë me to, të gjitha kanë lidhje me legjislacionin e sheriati. Allahu subhanehu ve teala thotë: *"Për Zotin tënd jo, ata nuk kanë besuar (në atë që të zbrii ty, as në atë para teje) derisa të mos të të zgjedhin për të gjykuar në atë mospajtim mes tyre dhe pastaj (pas gjyqimit tënd) të mos ndiejnë kënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos nënshtrohen plotësisht."*

*"E nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashetrojeni atë tek Allahu (libri i Tij) dhe tek i Dërguari (Sunneti i tij), po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së Fundit. Kjo është më e dobishme dhe përfundimi më i mirë."*<sup>[22]</sup>

Madje fikhu nga fillimi deri në fundin e tij nuk del nga kjo bazë gjithëpërfshirëse (sinqeriteti dhe pasimi i Sunnetit) sepse rregullat janë të nxjerra prej katër bazave: nga Kur'ani dhe Sunneti, të cilat janë origjina, ixhmai, që është i mbështetur në Kur'an dhe Sunnet si dhe kijasi, që është i nxjerrë prej Kur'anit dhe Sunnetit.

Marrë nga libri *"El Kavaidu vel Usulul Xhamiah", faqe 25, nga Shejhul Al-lame Abdurrrahman bin Nasër Es-Sa'di (rahimehullah)*  
Përshtati: Adem AVDIU  
Gjakovë/Kosovë

[16] Transmeton Ebu Davudi në "Sunenin" (2870), Tirmidhiu në "Sunenin" (2121), Ibën Maxhe në "Sunenin" (3/27) dhe po ashtu e transmetojnë Abdurrezaku (16308), Said ibn Mensur (427), Ibën ebi Shejbeh (11/149), Ibnul Xharud (949), Taberani në "Kebir" (7531), Bejhekiu (6/212) dhe Ibën Adij (290) prej rrugës së transmetimit nga Ismail ibën Ajash nga Sherhebil ibën Muslim el Havlani nga Ebi Emameh radijAllahu anhu. Ka heshtur për të Ebu Davudi dhe e ka bërë hasen Tirmidhiu dhe kjo është nga transmetimi i Ismail ibën Ajashit, nga Ehlul Shami, ngase Sherhebil ibën Muslim është nga të besueshmit e Shamit dhe transmetimet e Ismail ibën Ajashit prej shamiinëve janë sahih. Ka thënë për këtë Imam Ahmedi dhe Buhariu.

[17] Ehlus-Sunen janë autorët e sunenëve: Ebu Davudi, Nesaiu, Tirmidhiu dhe Ibën Maxhe (sh.p.).

[18] Hadithi "Muslimanët mbajn premtimet e dhëna" është prej mualekateve të Buhariut, shiko "Fer'hul Barin 4/451 bi sigatit xhezëm." E ka transmetuar me sened të plotë (mevsulen) Imam Ahmedi (2/366), Ebu Davudi (3594), Ibën Xharudi (637), Hakimi (2/45) dhe Ibën Adij (2088) nga Ebu Hurejra prej rrugës së transmetimit nga Kethir ibën Zejdi, nga Velid ibën Rebah. Po ashtu e transmeton Tirmidhiu (1370) nga Kethir ibën Abdullah ibën Amër ibën Auf el Mezinij nga babai i tij e ky nga giyshti i tij, se Resulullahu sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Pajtimi është i lejuar mes muslimanëve, përveç pajtimit që e ndalon të lejuarën apo që e lejon të ndaluarën dhe muslimanët i përmbahen kushteve të tyre, me përjashtim të kushtit që e bën të ndaluar të lejuarën apo që e bën të lejuar të ndaluarën." Kështu e transmeton Tabariu në "Kebir" (30), Ibën Adij (2081), Darekutni (3/27), Bejhekiu (6/79) dhe Ibën Maxhe (2353) pa fjalinë e fundit dhe për të ka dëshmi prej hadithit të Aishes, Enesit, Abdullah ibn Umerit dhe Rafi ibën Hadixh radijAllahu anhum dhe ky hadith është i besueshëm me të gjitha këto rrugë.

[19] Transmeton Buhariu në "Sahihun" (6696).

[20] Transmeton Muslimi në "Sahihun" e tij nga Ebu Hurejra radijAllahu anhu (1650).

[21] En Nisa: 65.

[22] En Nisa: 59.



KOMENT I SHKURTËR I MUHADITHIT TË  
MEDINËS, SHEJH ABDULMUHSIN EL-ABBAD,  
RRETH FJALËS SË IMAM SHATIBIUT:

“NUK ËSHTË I NEVOJSHËM  
PËRCAKTIMI I PERSONIT QË KA  
BËRË NDONJË BIDAT, NËSE  
BIDATI (NË FJALË) NUK ËSHTË  
PREJ BDATEVE TË MËDHA”

*Kjo fjalë ka të bëjë me një dijetar kur gabon dhe në këtë gabim ka ndonjë bidat. Ky dijetar nuk trajtohet ashtu siç trajtohen bidatçinjtë që i shmangen Ehlu Sunnetit dhe Xhematit dhe janë kundërshtues të Ehlu Sunnetit dhe Xhematit.*

**I**mam Shatibiu është njëri prej dijetarëve më me eksperiencë rreth çështjeve të bidatit dhe rregullave rreth tij dhe autor i dy librave të famshëm, “El-muvafakat” dhe “El-i'tisam”.

Libri i tij i njohur “El-i'tisam” është prej librave më të mirë që është shkruar në historinë islame në shkencën e bazave të bidatit, siç thotë Imam Albani rahimehullah në shumë incizime të takimeve të tij me nxënësit e dijes. Ky është libër bazë sa u përket bidateve, saqë është konsideruar libër i pashembullt në sqarimin e bidatit, ndarjes dhe rregullave të tij dhe njëherazi shtyllë prej shtyllave të për-

mirësimit islam sepse nuk ka musliman që e lexon këtë libër e të mos e urrejë bidatin dhe të mos paralajmërojë prej tij, të mos e dojë Sunnetin dhe të thërrasë në të. Kërkuesi serioz i dijes duhet ta ketë në librarinë e tij këtë thesar të pashtershëm, librin e imamet selef, Imam Shatibiut rahimehullah. Kushdo që ka shkruar diçka pas tij në shkencën e bidatit është mbështetur te ky libër.<sup>[1]</sup>

Shejh AbdulMuhsini, Allahu e ruajtë, gjatë komentimit të “Dyzet haditheve të Neveviut” është pyetur kështu: “Ju lusim që të na sqaroni kuptimin e fjalës së Shatibiut rahimehullah në “El-muvafakat”

[1] El-Iatizam 1/7-13, me recensim të shejh Mesh'hur Hasen Selman.

kur thotë: “Nuk është i nevojshëm përcaktimi i personit që ka bërë ndonjë bidat, nëse bidati (në fjalë) nuk është prej bidateve të mëdha, si ai i havarixhëve, në mënyrë që të ruhet bashkimi e dashuria mes radhëve të muslimanëve të zakonshëm.”

Përgjigjja: “Kjo fjalë ka të bëjë me një dijetar kur gabon dhe në këtë gabim ka ndonjë bidat. Ky dijetar nuk trajtohet ashtu siç trajtohen bidatçinjtë që i shmangen Ehlu Sunnetit dhe Xhematit dhe janë kundërshtues të Ehlu Sunnetit dhe Xhematit.

Domethënë, nëse kjo ndodh te ndonjë prej dijetarëve (të Sunnetit), ai arsyetohet për këtë, kështu që nuk shpallet bidatçi, as nuk bojkotohet, as nuk braktiset e vërteta që gjendet tek ai (nga dija dhe qëndrimet) për shkak të një gabimi të tij, ngase sa e sa dijetarë të tjerë dhe kërkues të dijes janë të varur prej dijes se tyre. Ata dijetarë kanë rënë në ndonjë bidat, mirëpo sikur të ishin trajtuar siç trajtohen bidatçinjtë, kurrë nuk do të ishte marrë diçka nga dija dhe veprat e tyre. Dihet shumë mirë se ka pasur dijetarë që ka qenë prej ehlul hadithit dhe u janë refuzuar gjëra në çështje të akides, sikur të ketë pasur ndonjë pështjellim në çështje të akides, ngase është sprovuar me disa nga hoxhallarët e tij dhe zakonisht dëmi dhe belaja mbi nxënësit bie nga hoxhallarët e tyre të devijuar.

Prandaj, çdo dijetar i Sunnetit që ka bërë ndonjë gabim në akide apo jashtë akides nuk trajtohet siç trajtohen bidatçinjtë, për shembull kaderitë, mutezilitë, rafiditë, havarixhët, porse merret dije nga ai

dhe bëhet dua për të, mirëpo nuk pasohet në gabimin e tij.”

Këtu përfundon përgjigjja e shejhut, Allahu e ruajttë.

Shtojcë

Pasi u dha përgjigjja e shejh Abadit, Allahu e ruajttë, muhadithit të Medinës, siç e ka cilësuar Imam Albani rahimehullah në librin e tij “Es-silsiletu es-sahiha”, desha të sjell disa shembuj për t’ju verifikuar praktikisht fjalën e Imam Shatibiut rahimehullah dhe komentin e shejh Abadit, Allahu e ruajttë, në mënyrë që të mos mbetet vend për dyshime për askënd nga lexuesit rreth këtij parimi shumë të rëndësishëm për çdo musliman, të aprovuar nga këta dijetarë verifikues.

Prej këtyre shembujve por të tillë ka edhe më shumë se kaq është shembulli i dijetarëve të mëdhenj të mëhershëm, si San’ani, Siddik Hasen Hani e Shevkani, para tyre Imam Neveviu, Ibën Haxheri e të tjerë.

Të gjithë këta kanë qenë dijetarë të mëdhenj të Sunnetit, fondamenti i tyre ka qenë Sunneti, lufta kundër bidatit dhe asnjëri prej tyre nuk e ka kundërshtuar në parim esencialitetin e Ehlu Sunnetit, mirëpo kanë gabuar në disa ixhtihadate. Megjithatë dijetarët e Ehlu Sunnetit nuk i kanë nxjerrë prej rrethit të tyre, as nuk i kanë paralajmëruar të tjerët prej përfitimit nga dija dhe librat e tyre, përkundrazi, edhe ata dijetarë kanë marrë dhe akoma marrin prej dijeve të tyre, duke mos harruar të theksojnë parimin nga fjala profetike, parim të cilin imam Albani rahimehullah e kishte zakon t’ua kujtonte të tjerëve: Nëse muxhtehidi ia qëllon, ka dy shpërblime, e nëse gabon

në ixhtihad, ka vetëm një shpërblim.

Po filloj me ata më të mëvonshmit dhe të hershmit po i lë në fund, duke i kujtuar lexuesit se qëllimi i kësaj përgatitjeje nuk është assesi nxjerrja në shesh e gabimeve të tyre dhe nënvlerësimi i meritave të tyre. Kërkoj mbrojtje nga Allahu që të mos jem prej injorantëve, porse, siç e thashë më lart, qëllimi im është vërtetimi i asaj fetvaje të artë të shejh Abadit me shembuj praktik nga dijetarët tanë Allahu na bashkoftë me ta në xhennetet e Allahut, në mënyrë që të jetë sa më e qartë për muslimanët tanë dallimi mes atyre që në esencë janë pasues të Sunnetit, por kanë ndonjë gabim, dhe atyre që bazament të tyre nuk kanë Sunnetin dhe udhëzimin pejgamberik.

Po e filloj me të mëvonshmit, kurse të hershmit po i lë në fund, me shpresë që edhe përfundimi nga leximi i këtij punimi modest të jetë i frytshëm dhe i mirë si misku.

Imam San'ani është autor i shumë librave, ndër të cilët “Subulus Selami”, libër fikhu nga hadithet e dispozitave, i cili mësohet në shumë universitete islame. Shumë dijetarë selefij ua mësojnë nxënësve të tyre këtë libër dhe libra të tjerë të këtij alimi të madh. Ky dijetar ka qenë prej atyre që është cilësuar si njeri me “vlerë të lartë”, “nga imamët ripërtëritës të shenjave të fesë”, “imam i madh dhe me merita të mëdha”, “njeri që ka pasur vullnet të madh në pasimin e Sunnetit dhe qortimin e bidatit dhe

ithtarëve të bidatit”, “nga imamët e tevhidit”.<sup>[2]</sup> Ky imam, Allahu e mëshiroftë, ka pasur disa gabime edhe në çështje të akides, siç i ka shprehur në “Divanin” e tij, ka thënë edhe disa fjalë të pakëndshme për Muaviun radijAllahu anhu dhe ka thënë se të gjithë sahabët janë “udul” (të drejtë e besnikë, nuk pyetet për ta se a u merret hadithi apo jo), përveç atyre që kanë bërë gjynahe të mëdha! Me këtë ka gabuar sepse me konsensusin e dijetarëve, të gjithë sahabët janë udul pa përjashtime dhe ai me këtë ka rënë në ujdin me Bakilanin e mutezilive... Pastaj ka mohuar “kerametet e evlijave”, duke rënë në ujdin me mutezilitë. Për Cilësitë e Allahut ka thënë se lejohet te’evili i haditheve në këtë fushë.<sup>[3]</sup>

Mirëpo, me gjithë ixhtihadet e gabuara, prapëseprapë ky dijetar ka mbetur në rrethin e Ehlu Sunnetit, është cilësuar me të gjitha meritat që i përmendëm më lart dhe dijetarët kurrë nuk kanë paralizuar nga dija e tij, përkundrazi librat e tij mësohen anekënd botës nga dijetarët e këtij ummeti sepse esenca dhe bazamenti me të cilin është njohur ky dijetar ka qenë Sunneti, nuk ka qenë në kundërshtim me akiden selefite në esencë, as në tevhid, as nuk ka qenë kundër përkrahjes dhe triumfit të Sunnetit pejgamberik, as nuk e ka kundërshtuar Ehlu Sunnetin në luftimin e bidatit, mirëpo ka gabuar në disa çështje. Në to ai nuk pasohet, nuk ndiqet dhe prej tij përmendet vetëm dija e saktë, kurse gabimet e tij nuk kanë qenë preokupim e as pëshpëritje e dije-

[2] “el-Bedru et-Tali” 2/137 i Shevkanit, “Tebrietush-Shejhajni”, fq. 82, i Al-lames Sahmani, “Divanus-San'ani” i shejh Muhammed ibën Manië të tjerë.

[3] shih “Divanin” e tij, “Themeratun-Nadhar”, fq. 106 dhe 113, po ashtu “El-insaf fi hakikatil-evlija”, fq. 65, “Ixhabetus sail”, fq. 114, po ashtu libra të tij.

tarëve të Sunnetit.

Madje imam San'ani njëherë pati shkruar një vjershë ku kishte qortuar imam Abdulvehabin rahimehullah dhe kjo vjershë pastaj është keqpërdorur nga bidatçinjtë, por ai pastaj është kthyer nga ajo duke thënë: “Jam kthyer nga fjala që kam thënë për Nexhdiun (Abdulvehabin).”

Megjithatë kritikën e parë dijetarët e tevhidit, qofshin ata nga nipat e Abdulvehabit apo nga të tjerët që kanë jetuar në atë kohë apo edhe pastaj deri më sot, nuk ia përmendin fare. Përkundrazi, dijetarët e tevhidit, sidomos ata të Hixhazit, kanë shkruar fjalë të mira për të dhe e kanë lavdëruar. I tillë është dijetari i madh Sulejman es-Sahman rahimehullah, i cili e ka lavdëruar në librin e tij “Tebrietu esh-Shejhejn (el-Imam es San'ani vesh-Shevkani)”.

Kurse Shejh Luhejdani, Allahu e ruajtë, ish-gjykatësi suprem i Arabisë Saudite, ka rrëfyer se e ka pyetur njëherë hoxhën e tij, dijetarin e madh Muhammed ibën Ibrahim Alu Shejh rahimehullah, ish-muftiun e Saudisë, imam i tevhidit gjithashtu, prej familjes së Abdulvehabit, se a ka qenë ajo vjershë e San'anit apo jo. Shejh Muhamed Ibën Ibrahim rahimehullah është përgjigjur: “Si duket ajo është e tij dhe të gjithë hoxhallarët tanë e kanë aprovuar se është e tij, mirëpo nuk dëshirojnë që t'i përmendet sepse ai e ka ndihmuar Sunnetin dhe ka refuzuar bidatin, edhe pse ka kritikuar davetin (e Abdulvehabit) dhe në këtë vjershë ka folur kundër shejh Muhammed ibn AbdulVehhabit. Shevkani gjithashtu ka një kaside të shkruar që ia ka dërguar Imam Su'udit rahimehullah, duke e ndaluar nga

shumë vepra si vrasja dhe zgjerimi në vendbanime dhe gjëra të tjera. Mirëpo pozita e tyre është e ruajtur, porse aty ku kanë gabuar nuk pasohen dhe njëherazi ndalohet pasimi i tyre në ato çështje.”

2- Siddik Hasen Hani, alim i madh dhe i njohur, vdiq më 1307 h. Ai ka mësuar prej shumë muhadithëve të mëdhenj të Indisë, është autor i shumë librave, ndër të cilët edhe libri i fikhut “Er revda en-nedijje”, i verifikuar dhe recensuar nga imam Albani rahimehullah. Ky libër ai ka këshilluar që të mësohet, siç shkruhet në revistën “El-Esaleh” (nr. 5, fq. 59). Hani është autor i librit “Ed-dinu el-halis”, një libër i çmuar lart nga dijetarët. Ky dijetar kishte kritikuar shumë davetin e Imam AbdulVehhabit rahimehullah, por megjithatë dijetarët i kanë mbyllur sytë këtu dhe nuk janë marrë me këtë për shkak të esencës së shëndoshë tek ai, realizimit të tevhidit dhe luftës kundër shirkut. Edhe pse disa janë munduar t'i ulin vlerat e tij (të ndikuar nga një shkruer nazaretist) dhe e kanë akuzuar se librat e tij nuk janë shkruar prej tij, por janë përmbledhje nga libra të shumtë, dijetarët e drejtë (si El Kittani në “Fehresul Feharis” 2/1057, autor i librit të mrekullueshëm “Er risaleh el mustatrafeh”) e kanë mohuar këtë akuzë dhe kanë shtuar se edhe përmbledhja nga librat e tjerë, shkurtimet, shtimet, rregullimi, vënia e titujve dhe e kapitujve është një punë e metodologji e cila aludon për thellësinë e njohurive të tij, aludon për vëzhgimin e tij të madh të shkencave të ndryshme dhe librave, leximin e studimin e tyre dhe gjithsesi nuk është punë e lehtë, siç men-

dojnë disa që i referohen dijes dhe studimit.<sup>[4]</sup>

3- Edhe Imam Shevkani rahimehullah, muhadith, fekih, mufesir, ekspert i shkencës së usulit, kishte gabuar në çështjen e tevesulit, kishte ixhtihad të gabuar në Cilësitë e Allahut gjatë komentimit të disa ajeteve dhe gjithashtu ka lënë disa fjalë jo të mira për sahabin Umer ibnul Hattabi radijallahu anhu dhe Muaviun po ashtu, mirëpo dijetarët kurrë nuk ia përmendin atë. Përkundrazi, siç thamë më lart, shejh Sehmani rahimehullah, një nga imamët e davetit të Hixhazit, kishte shkruar një libër në mbrojtje të Imam Shevkanit, autorit të shumë librave dhe posaçërisht “Nejlul Evtarit”, libër që mësohet në të gjitha universitetet islamike, përfshirë edhe Universitetin e Medinës. Shumë dijetarë selefij ua mësojnë nxënësve të tyre këtë libër dhe ua rekomandojnë të tjerëve mësimin e tij. Madje ky libër që mësohet në Universitetin e Medinës që nga themelimi i tij është vendosur për t’u mësuar nga dijetarët e mëdhenj si Imam Bin Bazi rahimehullah, i cili ishte prej themeluesve të Universitetit të Medinës. Kam dëgjuar nga disa vëllezër që kanë studiuar në atë universitet se ata kanë dëgjuar mësuesit e tyre duke thënë se libri “Nejlul Evtar” i Shevkanit rahimehullah është libër për dijetarë dhe kërkues të rinj të dijes. Edhe Imam Albani, me gjithë gabimet e Shevkanit, shumë herë argumenton me dijen dhe librat e tij dhe e konsideron si dijetar të madh të shkencave të

ndryshme, por ka marrë prej tij atë që është e mirë, domethënë shumica e dijes së tij (edhe pse në disa raste e ka kundërshtuar mendimin e Shevkanit). Siç e përmendëm më lart dhe nga ajo që sollëm prej fetvasë së shejh Abadit, esenca e tij është Sunneti, mbrojtja e tij, tevhidi dhe refuzimi i bidatit e shirkut, madje Shevkani ka një libër shumë të vlefshëm që i përkushtohet tërësisht ndalimit të ngritjes së varreve me bidatat e ndryshme të përhapura nëpër varret e muslimanëve, një libër të cilin jam duke e përkthyer. Ky libër aprovon tevhidin e pastër dhe luftën kundër shirkut dhe bidatit.

Në përgjithësi, daveti i Imam Shevkanit është përqendruar në tri pika:

- thirrja në ringjalljen e ixhtihadit dhe tretjen e pasimit të verbër,
- thirrja në akiden selefite,
- thirrja në spastrimin e akides nga dukuritë e shirkut të fshehtë<sup>[5]</sup>

Vijon...

*Përgatiti: Zejd HAZIRI  
11 Dhul-Hixheh 1431 h  
Gjilan/Kosovë*

[4] “Et-Tealikat er-Redijeh” 1/24.

[5] Fet’hul Kadir 1/16.

# SI TË LUMTUROHET JETA E DY BASHKËSHORTËVE

*Thirrja është e dyanshme, si për gruan edhe për burrin, që t'i kryejnë obligimet që kanë ndaj njëri-tjetrit dhe pa dyshim se qëllimi kryesor i tyre është që me veprimet e tyre ta kënaqin Allahun e Madhëruar, në mënyrë që të arrihet lumturia mes tyre në dunja dhe shpresojmë xhennetin në ahiret.*

Falënderimi i takon Allahut, që krijoi Ademin alejhis selam, njeriun e parë, ndërsa pas tij krijoi edhe Havën, gruan e tij, që ai të ketë mbështetje dhe nevojë për të.

Marrëdhënia miqësore mes bashkëshortëve është boshti i lumturisë. Miqësia e tyre pas martesës fillon me gjëra të qeta dhe mbresa pozitive, mirëpo me kalimin e kohës raporti mes tyre mund të humb kuptimin dhe këtu fillojnë edhe problemet, që janë gjëja më e rrezikshme mes dy bashkëshortëve sepse shkaktojnë sprova që shpeshherë rezultojnë me ndarje ose përfundime të detyrueshme jo të mira për ta.

Të dy bashkëshortët duhet t'i kushtojnë rëndësi njëri-tjetrit, t'i trajtojnë problemet mes tyre në formën më të mirë, të forcojnë lidhjen dhe dashurinë mes tyre. Por si mund të ruhet dhe forcohet lidhja e tyre martesore?

Burri dhe grua duhet të kenë kujdes për llogarinë dhe obligimet ndaj njëri-tjetrit, kurse problemet e tyre t'i kurojnë nga fillimi e jo në fundin e tyre.

Dihet se marrëdhëniet mes tyre janë të lidhura me dashuri, qetësi dhe prehe, nuk janë raporte zyrtare. Pra, emocionet dhe dashuria janë lidhja që e forcon më shumë dhe e bën më të afërt raportin mes tyre.

Të dy bashkëshortët duhet t'i ruajnë emocionet, dashurinë dhe respektin reciprok mes tyre që nga dita e parë e martesës. Nuk lejohet që tek ata duhet të mbizotërojë zakoni i turpfit dhe të ndalojë fjalorin e dashurisë dhe miqësisë që kërkohet mes tyre, i cili ua bën jetën të lumtur.

Disa gra i japin rëndësi të madhe zbukurimit kur dalin nga shtëpia apo kur takohen me motrat e tyre, por nuk i kushtojnë shumë rëndësi zbukurimit para burrit të tyre, ndërkohë që kur Muhamedi sal-Allahu alejhi ve sel-lem është pyetur se cila grua është më e mira, ka thënë: "Ajo që kënaqet syri i burrit të saj kur e shikon atë." (Ebu Davudi, Ibën Maxheh.)

Thirrja është e dyanshme, si për gruan edhe për burrin, që t'i kryejnë obligimet që kanë ndaj njëri-tjetrit dhe pa dyshim se qëllimi kryesor i tyre është që me veprimet e tyre ta kënaqin Allahun e Madhëruar, në mënyrë që të arrihet lumturia mes tyre në dunja dhe shpresojmë xhennetin në ahiret.

Mes tyre duhet të ketë nxitje për faljen e namazeve, për agjërim

dhe haxh, këshillim për ndihmë ndaj të varfërve.

Muhamedi sal-Allahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Allahu e mëshiroftë njeriun që ngrihet natën, fal namaz, e zgjon gruan e vet dhe ajo fal namaz. E nëse nuk zgjohet, atëherë e lag me ujë në fytyrë. Allahu e mëshiroftë gruan që ngrihet natën, fal namaz, e zgjon burrin e saj për namaz. E nëse nuk zgjohet, e lag me ujë në fytyrë." (Ibën Maxheh)

Asnjëri prej tyre të mos përqeshë apo të tallet me fizionominë e tjetrit, pasi kjo shkakton mosrespektim të plotë dhe mes tyre ndizet urrejtja dhe pastaj fillojnë grindjet dhe problemet, që fatkeqësisht përfundojnë me ndarje.

Çdonjëri prej tyre ta shikojë tjetrin si superior për të, sepse kjo sjell forcimin e besimit të tjetri dhe shpëtim e lumturi për të dy. Nuk arrihet lumturia kur ofendohet njëri prej tyre, qoftë në fizionomi apo mendime dhe bindje.

Ata duhet të krijojnë raporte të mira mes tyre, saqë çdonjëri prej tyre të ndiejë mangësi në shpirt gjatë mungesës së tij apo saj.

Ajo që e bën lidhjen e tyre më të ngrohtë janë fjalët e mira dhe respektuese që nga mëngjesi i freskët deri në mbrëmje.

Pa dyshim se xhelozia do të jetë e pranishme në mesin e tyre, ngase me xhelozia shtohet dashuria, mirëpo duhet të kenë kujdes që të mos jetë e tepruar dhe të ndikojë negativisht tek ta, duke shkaktuar pastaj dyshime, gënjeshtra dhe fund të keq.

Feja e pastër islame nuk e ndalon respektin ndaj gruas, përkundrazi, i jep asaj meritën që i takon. Në anën tjetër, nuk e bën gruan të jetë prijëse në shtëpi dhe secilit ia jep meritat e veta. Formula e vetme që e bën jetën mes dy bashkëshortëve të lumtur është respektimi i urdhrave të Allahut, praktikimi i Sunnetit të Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem, respektimi dhe kryerja e obligimeve ndaj njëri-tjetrit si dhe dashuria për hir të Allahut të Madhëruar.

Obligimet e burrit ndaj gruas dhe anasjelltas do t'i paraqesim në vijim, në mënyrë që secili prej tyre t'i njohë ato dhe jeta e tyre të jetë e lumtur.

Unejs MURATI  
Gjilan/Kosovë

# TRASHËGIMIA NË ISLAM (V)

*Thirrja është e dyanshme, si për gruan edhe për burrin, që t'i kryejnë obligimet që kanë ndaj njëri-tjetrit dhe pa dyshim se qëllimi kryesor i tyre është që me veprimet e tyre ta kënaqin Allahun e Madhëruar, në mënyrë që të arrihet lumturia mes tyre në dunja dhe shpresojmë xhennetin në ahiret.*

## TEMA E TETË LLOJET E TRASHËGIMISË

Trashëgimia është dy llojesh:

1. Trashëgimia me përmasë të caktuar (fard) dhe
2. Trashëgimia pa përmasë të caktuar (ta'sib).

\* Fard në etimologji ka disa kuptime:

- diçka e prerë, e vendosur
- diçka e ndarë për dikë
- përmasë e caktuar.

Kurse në terminologjinë e shkencës së trashëgimisë do të thotë përmasë e cak-

tuar nga sheriat i për trashëgimtarin e caktuar, e cila nuk shtohet përveçse me red<sup>[1]</sup> dhe nuk pakësohet përveçse me aul.<sup>[2]</sup>

\* Kurse kuptimi i ta'sibit do të vijë në temën e shtatëmbëdhjetë inshAll-llah.

## TEMA E NËNTË PËRMASAT E CAKTUARA NË LIB- RIN E ALLAHUT TË LARTËSUAR

Përmasat e caktuara të argumentuara janë gjashtë, si vijojnë:

1. Gjysma (1/2)

[1] Ndodh atëherë kur trashëgimtarët me përmasa të caktuara marrin pjesën e tyre që u takon nga pasuria dhe mbetet ende diçka prej saj, prandaj u shtohet trashëgimtarëve, përveç bashkëshortëve. Më vonë do kemi edhe sqarimin e hollësishëm inshAllah (sh.p).

[2] Ndodh atëherë kur pasuria e trashëguar nuk ndahet përveçse me pakësim nga çdo përmasë e trashëgimtarit. Do të vijë më vonë inshAllah sqarimi i hollësishëm (sh.p).

2. Një e katërta (1/4)
3. Një e teta (1/8)
4. Dy të tretat (2/3)
5. Një e treta (1/3)
6. Një e gjashta (1/6).

## ARGUMENTET E PËRMASAVE TË CAKTUARA

- Argumenti për gjysmën (1/2): Allahu i Lartësuar thotë: *"Juve ju takon gjysma e asaj që lanë gratë tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë..."* [3]

- Argumenti për një të katërtën (1/4): Allahu i Lartësuar thotë: *"...E nëse ato (gratë) kanë fëmijë, atëherë juve (bashkëshortëve, burrave) ju takon një e katërta prej asaj që lanë..."* [4]

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë: *"Atyre (bashkëshorteve, grave) u takon një e katërta e asaj që keni lënë..."* [5]

- Argumenti për një të tetën (1/8): Allahu i Lartësuar thotë: *"...e nëse ju keni fëmijë, atëherë atyre (bashkëshorteve) u takon një e teta e asaj që keni lënë..."* [6]

- Argumenti për dy të tretat (2/3): Allahu i Lartësuar u dha bijave të trashëgimitarit këtë përmasë kur thotë: *"...e nëse janë (femrat) dy e më shumë, atëherë atyre u takojnë dy të tretat e pasurisë..."* [7]

- Argumenti për një të tretën (1/3): Allahu i Lartësuar thotë: *"...nëse ai nuk ka*

*fëmijë dhe e trashëgojnë atë prindërit, atëherë nënës së tij i takon një e treta e pasurisë..."* [8]

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar u dha këtë përmasë gjysmëvëllezërve (vëllezërve nga nëna), kur thotë: *"...e nëse janë më shumë se një (vëllezër nga nëna), ata trashëgojnë së bashku një të tretën e pasurisë..."* [9]

- Argumenti për një të gjashtën (1/6): Allahu i Lartësuar thotë: *"...nëse keni fëmijë, atëherë çdo prindi i takon një e gjashta e pasurisë..."* [10]

## TEMA E DHJETË TRASHËGIMTARËT E GJYSMËS SË PASURISË

Ata janë pesë persona që duhet të plotësojnë kushtet paraprake si vijon:

- 1- Bashkëshorti (burri)
- 2- E bija
- 3- E bija e të birit
- 4- Motra e plotë
- 5- Gjysmëmotra (motra nga babai).

## KUSHTET E BASHKËSHORTIT PËR TË TRASHËGUAR GJYSMËN E PASURISË

Për të arritur këtë ka vetëm një kusht (mosprezence) mohues, mosprezenca nga ana degëzore, të cilët janë fëmijët e të vdekurit apo fëmijët e fëmijëve pa marrë parasysh se a janë meshkuj apo

[3] En-Nisa: 12.

[4] En-Nisa: 12.

[5] En-Nisa: 12.

[6] En-Nisa: 12.

[7] En-Nisa: 11.

[8] En-Nisa: 11.

[9] En-Nisa: 12.

[10] En-Nisa: 11.

femra apo të përzier meshkuj e femra, një apo më shumë me shkallë të afërsisë së njëjtë apo më larg nga e njëjta bashkëshorte apo tjetra. Argument për këtë kusht është fjala e Allahut të Lartësuar: *"Juve ju takon gjysma e asaj që lanë gratë tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë..."* [11]

## KUSHTET E SË BIJËS PËR TË TRASHËGUAR GJYSMËN E PASURISË

Për të arritur këtë ka dy kushte mosprezenca (mohuese):

1- Mosprezenca e vëllait të saj, pa marrë parasysh a është ai vëlla i plotë (nga babai dhe nëna) apo gjysmëvëlla (vetëm nga babai apo nëna). Argument për këtë kusht është fjala e Allahut të Lartësuar: *"Allahu ju urdhëron për (çështje të trashëgimisë) fëmijët tuaj: birit i takon aq sa u takon dy bijave, e nëse janë më shumë se dy bija, atëherë atyre u takojnë dy të tretat nga ajo që ka lënë. E nëse është vetëm një bijë, asaj i takon gjysma e pasurisë..."* [12]

Të argumentuarit me këtë ajet është si vijon: bija merr gjysmën e asaj që i jepet birit kur janë së bashku. Allahu nuk i dha asaj gjysmën, përveç nëse ajo është e vetme nga fëmijët.

2- Të mos ketë shoqëruese, që janë motra apo motrat e saj, qofshin ato të plota apo gjysmëmotra. Argument për këtë kusht është fjala e Allahut të Lartësuar: *"...e nëse është vetëm një bijë, asaj i takon gjysma e pasurisë..."* [13]

Të argumentuarit me këtë ajet është si vijon: për t'i dhënë bijës gjysmën e pasurisë, duhet të jetë e vetme, po pati shoqërues nuk do t'i takonte një përmasë e tillë.

## KUSHTET E BIJËS SË TË BIRIT PËR TË TRASHËGUAR GJYSMËN E PASURISË

Për të arritur këtë ka tre kushte mosprezenca (mohuese):

1- Mosprezenca nga ana degëzore e dikujt që është më i afërt se ajo, pa marrë parasysh a janë fëmijë të të vdekurit apo fëmijë të fëmijëve të të vdekurit. Argument për këtë kusht është ixhmai (konsensusi) i dijetarëve, saqë nuk ka asnjë kundërshtim që e bija e të birit nuk trashëgon gjysmën e pasurisë duke qenë prezent dikush nga ana degëzore që është më i afërt se ajo.

2- Mosprezenca e vëllait të saj, pa marrë parasysh a është ai vëlla i plotë apo gjysmëvëlla (nga babai), apo biri i xhaxhait që është në të njëjtën shkallë me të.

3- Mosprezenca e shoqërueses, që është motra e saj e plotë apo gjysmëmotra (nga babai), apo e bija e xhaxhait të saj që është në të njëjtën shkallë me të. Argument për këto dy kushtet e fundit është ixhmai (konsensusi) i dijetarëve, saqë nuk ka asnjë kundërshtim që bija e të birit nuk trashëgon gjysmën e pasurisë duke qenë prezent vëllai, biri i xhaxhait apo ndonjë nga shoqëruesit e saj.

[11] En-Nisa: 12.

[12] En-Nisa: 11.

[13] En-Nisa: 11.

## KUSHTET E MOTRËS SË PLOTË PËR TË TRASHËGUAR GJYSMËN E PASURISË

Për të arritur këtë ka katër kushte mosprezente (mohuese):

1- Mosprezenca nga ana degëzore që është më i afërt se ajo. Argument për këtë kusht është fjala e Allahut të Lartësuar: *"Nëse vdes një njëri që nuk ka fëmijë, por ka motër, atëherë asaj (motrës) i takon gjysma e pasurisë që ka lënë ai..."*<sup>[14]</sup>, dhe qëllimi me fjalën motër në ajet është motra e plotë dhe gjysmëmotra (motra nga babai). Kjo është e argumentuar me ixhma (konsensus) të dijetarëve. Për t'i takuar asaj gjysma e pasurisë duhet të mos jetë dikush më i afërt se ajo nga ana degëzore.

2- Mosprezenca nga ana bazore, që janë ata prej të cilëve rrjedh njeriu nga radha e meshkujve.<sup>[15]</sup> Argument për këtë kusht është ajeti që u përmend më lart në kushtin e parë, ku të argumentuarit me ajet qëndron sepse "kelale" është ai i vdekur që nuk ka as fëmijë e as prindër, sipas mendimit më të zgjedhur të dijetarëve.

3- Mosprezenca e vëllait të saj, që është vëllai i plotë. Argument për kusht është ajeti i mësipërm, kur thotë Allahu i Lartësuar: *"...nëse trashëgimtarët janë vëllezër e motra, atëherë mashkullit i takon trashëgimi sa dy femrave (motrave)."* <sup>[16]</sup>

4- Mosprezenca e shoqërueses së saj, që

është motra e plotë e saj. Argument për këtë kusht është ajeti i mësipërm, ku Allahu i Lartësuar thotë: *"...në qoftë se ato janë dy (motra që trashëgojnë), atëherë atyre të dyjave u takojnë dy të tretat që lë ai (i vdekuri)."* <sup>[17]</sup>

## KUSHTET E GJYSMËMOTRËS (MOTRA NGA BABAI) PËR TË TRASHËGUAR GJYSMËN E PA- SURISË

Për të arritur këtë ka pesë kushte mosprezente (mohuese):

1- Mosprezenca nga ana degëzore e dikujt që është më i afërt se ajo.

2- Mosprezenca nga ana bazore nga radha e meshkujve.

3- Mosprezenca e vëllait të saj, pa marrë parasysh a është vëlla i plotë apo gjysmëvëlla (vëlla vetëm nga babai).

4- Mosprezenca e shoqërueses së saj, pa marrë parasysh a është motra e plotë e saj apo gjysmëmotra (motra nga babai). Argument për këto kushte janë argumentet e cekura më lart te kushtet e motrës së plotë.

5- Të mos ketë kjo gjysmëmotra, vëllezërit e motrat e plota. Argument për këtë është ixhmai (konsensusi) i dijetarëve.

Vijon

*"El-Feraid" i Dr. Abdul Kerim ibën  
Muhammed el-Lahim  
Përmbledhi dhe përshtati: Namik VEHAPI  
Gjakovë/Kosovë*

[14] En-Nisa: 176.

[15] Të cilët janë babai, gjyshi nga ana e tij, sado që të vazhdojë më lart.

[16] En-Nisa: 176.

[17] En-Nisa-176.